



**inject**

Initiative for  
Justice and Equality

# PASURIA E PËRBASHKËT DHE MBAJTJA FINANCIARE

## LIGJI DHE PRAKTIKA





**inject**

Initiative for  
Justice and Equality

# PASURIA E PËRBASHKËT DHE MBAJTJA FINANCIARE

## LIGJI DHE PRAKTIKA

Shtator 2019

Për finalizimin e këtij raporti ndihmuan:

**Luljeta Aliu**

Përgatitja dhe editimi i raportit

**Merita Shala**

Zhvillimi i intervistave

**Anton Nrecaj**

Jurist, përgatitja e kornizës ligjore

**Sami Kurteshi**

Lektorim

**Elheme Sylejmani**

Lektorim

**Visar Xhambazi**

Kontribues i jashtëm

**Erza Kurti**

Koordinimi i punëve

© 2019 Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga INJECT.

Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përaferta.

# CONTENTS

<b>SHKURTESAT</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE</b>	<b>6</b>
<b>METODOLOGJIA</b>	<b>8</b>
<b>GJENDJA AKTUALE</b>	<b>10</b>
<b>KORNIZA LIGJORE</b>	<b>15</b>
<b>E DREJTA E PRONËSISË ME MË SHUMË SUBJEKTE</b>	<b>18</b>
Kuptimi i pronësisë së përbashkët dhe dallimi nga bashkëpronësia	18
<b>MARRËDHËNIET PASURORE TË BASHKËSHORTËVE</b>	<b>20</b>
Pasuria e veçantë e bashkëshortëve	21
Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve	22
<b>REGJIMI PASUROR MARTESOR</b>	<b>26</b>
Pjesëtimi me marrëveshje i pasurisë së bashkëshortëve	27
Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes	29
Përcaktimi i pjesëve	31
<b>MBAJTJA FINANCIARE</b>	<b>33</b>
Vështrim i përgjithshëm	33
Mbjajtja martesore (Ushqimia)	35
<b>PRAKTIKA GJYQËSORE</b>	<b>41</b>
<b>NDARJA E PASURISË MES BASHKËSHORTËVE</b>	<b>41</b>
<b>MIRËMBAJTJA FINANCIARE MES BASHKËSHORTËVE</b>	<b>51</b>

<b>PËRFUNDIM</b>	<b>59</b>
<b>REKOMANDIMET</b>	<b>63</b>
<b>REFERENCAT</b>	<b>64</b>
LIBRA	64
RAPORTE DHE ARTIKUJ	64
LIGJET	67
INTERVISTAT	67
<b>SHTOJCA</b>	<b>69</b>
Pyetjet për Gjyqtarë dhe Avokatë	69
Pyetjet për Gratë e Divorcuara	70

# SHKURTESAT

<b>ASK</b>	Agjencia e Statistkave e Kosovës
<b>AGJB</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>INJECT</b>	Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi
<b>LFK</b>	Ligji për Familjen i Kosovës
<b>LMD</b>	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
<b>LPDTS</b>	Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore

## HYRJE

Një ndër problemet kyçe në Kosovë mbeten të drejtat e grave, krahas mungesës së sundimit të ligjit. Në shoqërinë kosovare ende mbizotëron një kulturë patriarkale, e cila funksionon sipas stereotipeve gjinore. Si pasojë grave i'u pamundësohet e drejta për vendimmarrje në çështjet familjare, biznese apo politike. Gjendja e grave në shoqëri është edhe më alarmante në zonat rurale të Kosovës, ku ndodhë që atyre ju mohohet shkollimi dhe mundësia e pjesëmarrjes në tregun e punës.

Përkundër përpjekjes që mendësia patriarkale mbizotëruese në vend të zbutet përmes përfaqësimit të grave në Kuvend me ndihmën e kuotës, kjo ndërhyrje nuk u tregua mjaftueshëm e suksesshme. Burrat ende përbëjnë shumicën dërmuese të pozitave të larta publike në Kosovë.<sup>1</sup> Po ashtu, partitë politike karakterizohen me një numër të vogël të grave.<sup>2</sup> Përfaqësimi i interesave të grave në Kuvend përmes grave deputete nuk ka arritur që të sjellë ndryshim substancial të pozitës së grave në shoqërinë kosovare.

Krahas përfaqësimit të ulët në politikë dhe në pozita vendimmarrëse në institucionet publike, gratë vazhdojnë të diskriminohen edhe në fusha shumë më esenciale siç është barazia para ligjit, qasja në trashëgimi dhe në pasurinë e krijuar gjatë martesës si dhe qasja në mbajtje financiare (alimentacion për fëmijët dhe ushqimi për gratë). Ky diskriminim ndaj grave ndodhë jo vetëm në rrethin familjar, por edhe në institucione. Janë pikërisht gjykatat e Kosovës, të cilat i kanë shkelur dispozitat ligjore në rastet e ndarjes së pasurisë dhe mbajtjes financiare. Ky diskriminim ka për pasojë mungesën e sigurisë financiare tek gratë, gjë që ndikon më pastaj në një gamë disavantazhesh të tjera në jetën e tyre.

---

1 Grupi i Ballkanit për Studim Politikash, "Gratë në Politikë," 2019, marrë nga <https://balkansgroup.org/blog/post/articles/grate-ne-politike-pabarazia-gjinore-ne-politike-dhe-vendimmarrje>

2 Ibid.



Gratë në masë të madhe zotërojnë ndjeshëm më pak pasuri dhe pronë. Vetëm 17% e grave kanë ndonjë pronë në emër të tyre.<sup>3</sup> Megjithëse Ligji për Familjen i Kosovës në dispozitat ligjore rreth pasurisë së përbashkët (neni 47) thekson së bashkëshortët janë pronarë të barabartë në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët të krijuar gjatë martesës, dispozitat ligjore janë interpretuar në mënyrë diskriminuese ndaj grave, duke e vlerësuar kontributin e grave me rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e shtëpisë më pak të vlefshëm se gjysma e pasurisë, duke e anashkaluar kësisoji Ligjin për Familjen.

Në nëntor të vitit 2017, themeluesja e Iniciativës për Drejtësi dhe Barazi INJECT, Luljeta Aliu, e kishte dorëzuar një kërkesë për ndryshimin e Ligjit për Familjen në Komisionin për Legjislacion të Kuvendit të Kosovës. Kërkesa për ndryshimin e ligjit bazohej në një analizë që Luljeta Aliu i kishtë bërë mënyrës se interpretimit të Ligjit për Familjen në dispozitat ligjore rreth pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare, duke argumentuar bindshëm rreth hapësirave dhe mangësive ligjore brenda ligjit e sidomos në praktikën gjyqësore.<sup>4</sup> Pas procedurave në Komision dhe Qeveri, kjo iniciativë për ndryshimin e Ligjit për Familjen kaloi për votim në Kuvend dhe ka hyrë në fuqi që nga janari 2019. Dispozita e ndryshuar i ka shpallur kontributet e bashkëshortëve të barasvlershme.<sup>5</sup> Kjo nënkupton se rritja dhe edukimi i fëmijëve si dhe mirëmbajtja e shtëpisë me ligj e kanë vlerën e njejtë si të ardhurat materiale të bashkëshortit të punësuar. Por, siç është theksuar edhe në Raportin e Progresit për Kosovën të Bashkimit Evropian për vitin 2018,<sup>6</sup> përkundër kornizës ligjore me standarde ndërkombëtare, problemi në Kosovë është implementimi efektiv i ligjeve në praktikën gjyqësore.

3 Nicole Farnsworth et al., "Analiza Gjinore e Kosovës," Rrjeti i Grave të Kosovës, 2018, marrë nga, <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

4 Aliu, Luljeta, „Ndryshimi i Ligjit për Familjen”, Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi INJECT, 2019, online në <https://inject-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/NdryshimiLigjiFamiljen.pdf>

5 Gazeta Zyrtare, LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS online në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18420>

6 Raporti i Progresit për Kosovën 2018, fq.25, online <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

Vlen të theksohet se Ligji për Familjen, edhe para se të bëhet ndryshimi i tij, e ka paraparë një ndarje të barabartë të pasurisë së përbashkët. Shtrebbërimi dhe diskriminimi është bërë në praktikën gjyqësore, e cila i ka interpretuar ligjet sipas një mentaliteti mbizotërues patriarkal dhe jo sipas dispozitave ligjore. Prandaj ka qenë e nevojshme që të bëhet një hulumtim i thellë, i cili do të dëshmonte këto mangësi dhe këtë diskriminim sistematik dhe sistemik brenda institucioneve të gjyqësorit.

Ky hulumtim që e keni në duar është një krahasim mes kornizës ligjore ekzistuese dhe praktikës gjyqësore. Tema e hulumtimit është pasuria e përbashkët dhe mbajtja financiare dhe mënyra si këto institute juridike trajtohen në gjykatat kosovare. Për këtë arsye hulumtimi ka zhvilluar intervista me gra të divorcuara dhe me gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe mbrotjës të viktimave.

## METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi dhe analiza e vështirësive, më të cilat përballen gratë gjatë procedurave gjyqësore të divorcit, ndarjes së pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare (alimentacioni dhe ushqimia). Meqë divorci në shoqërinë kosovare ende shihet si temë tabu, nuk ka qenë fare e lehtë për gratë të shprehen të gatshme për të dhënë intervistat për këtë hulumtim. Gjithsesi jemi falënderuese ndaj pjesëmarrësve në intervistat tona, sepse hulumtimi i kësaj çështjeje ka qenë shumë i nevojshëm në diskursin publik kosovar, marrë parasysh diskriminimin mbi baza gjinore para ligjit dhe në institucionet tona, viktimë e të cilit janë kryesisht gratë dhe fëmijët. Gatishmëria e gjyqtarëve, avokatëve dhe mbrotjësve të viktimave brenda prokurorisë që të marrin pjesë në intervistim ka mundësuar që të nxjerrim të dhënat rreth mënyrës se si aplikohen dispozitat ligjore në praktikën gjyqësore. Hulumtimi ka për qëllim që të demonstrojë pikërisht aplikimet e gabuara të

dispozitave që bëhen nga ana e gjyqësorit në raport me të drejtat e grave në Kosovë.

Në pjesën e parë të këtij hulumtimi paraqitet një përmbledhje e dispozitave ligjore në lidhje me ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe mbajtjen financiare. Në pjesën e dytë prezantohet praktika gjyqësore aktuale, e cila bazohet në të dhënat nga intervistat dhe gratë si dhe me profesionistët e lartëcekur. Pjesa tjetër e hulumtimit është një analizë e praktikës gjyqësore. Kjo pjesë është realizuar përmes intervistave me gra, të cilat janë ballafaquar me procedura gjyqësore në njërën anë dhe me gjyqtarë, avokatë, prokurorë dhe mbrojtës të viktimave në anën tjetër. Kjo qasje na ka mundësuar të krahasojmë të dhënat dhe të nxjerrim rezultatet rreth dallimit mes të drejtave të garantuara me ligj dhe aplikimin e tyre në praktikën gjyqësore.

Hulumtimi synon që përmes gjetjeve dhe rekomandimeve të dalë të shërbejë si një avokim për organet e rendit siç janë: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese. Gjithashtu, ky hulumtim ka për qëllim që të shërbejë si mjet vetëdijësues për gratë, organizatat jo-qeveritare dhe shoqërinë në përgjithësi.

Hulumtimi mëton të ndikojë pozitivisht në ngritjen e vetëdijes rreth nevojës për ndryshim të praktikës gjyqësore në lidhje me ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare. Praktika gjyqësore në Kosovë nuk i ka respektuar dispozitat ligjore në çështjet e ndarjes së pasurisë dhe mbajtjes financiare. Grupet e targetuara janë gjyqësori, prokuroritë, mbrojtësit e viktimave, avokatët, shoqëria civile dhe gratë. Për këtë arsye, hulumtimi fillimisht ka përfshirë analizën e kornizës ligjore dhe elaborimin ligjor të dispozitave kyçe të ndërlidhura me ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe mbajtjen financiare.

Për realizimin e analizës së praktikës gjyqësore janë përdorur metoda kualitative, përkatësisht janë organizuar intervista personale të ndara në dy grupe. Njëzet (20) intervista janë realizuar me gra që janë ballafaquar me

procedura gjyqësore dhe njëzet (20) intervista me gjyqtarë, avokatë dhe mbrojtës të viktimave. Gratë të cilat janë të përfshira në këtë hulumtim vijnë nga regjioni i Prishtinës, ndërsa avokatët dhe gjyqtarët vijnë nga regjioni i Prishtinës dhe Gjilanit. Po ashtu, pyetjet për intervista janë ndarë në dy kategori, për gratë e divorcuara dhe për gjyqtarë e prokurorë. Pyetjet për gratë e divorcuara janë rreth 50-të, ndërsa për gjyqtarë e prokurorë janë gjithsej 16-të. Pyetjet e listuara gjenden në shtojcën (appendix) e dokumentit.

Realizimi i intervistave është bërë në tre mujorin e dytë të vitit 2019, përkatësisht periudha mars-qershor. Rreth 90% e grave të intervistuar në këtë punim i takojnë moshës 25-44 vjeçare dhe 95% prej tyre kanë deklaruar se kanë fëmijë. Shumica prej tyre kanë deklaruar se martesë e tyre ka zgjatur nga një deri në dymbëdhjetë vite. Për shkak të ruajtjes së privatësisë të gjitha intervistat janë të anonimizuar, sepse gratë e divorcuara të anketuara nuk kanë dëshiruar që të zbulohet identiteti i tyre. Mirëpo, organizata INJECT i posedon të gjitha intervistat në arkiva të organizatës. Sa i përket gjyqtarëve dhe prokurorëve, ata citohen me emrat e plotë në këtë hulumtim.

## GJENDJA AKTUALE

Në Kosovë vetëm 13.3 % të grave janë të punësuar.<sup>7</sup> Në asnjë vend tjetër të Evropës numri i grave të punësuar nuk është kaq i ulët. Papunësia apo situata e vështirë ekonomike nuk shkakton doemos dhunë, por varësia financiare e grave e sjell gruan në një situatë që ajo të jetë e nënshtruar duke mos marrë guximin as të protestojë ndaj dhunës dhe lëre më të raportojë.<sup>8</sup> Hulumtimet tregojnë se 40.9% të grave kanë deklaruar se vuajnë nga dhuna në familje.<sup>9</sup>

---

7 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2009, fq. 14, online në <http://ask.rks-gov.net/media/4854/anketa-e-tregut-te-punes-tm1-2019.pdf>

8 Luljeta Aliu, Ndryshimi i Ligjit për Familjen, f. 11.

9 Rrjetit i Grave të Kosovës, Mjaft më me arsyetime, fq. 46, online [https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/RrGGK\\_Mjaft%20m%C3%AB%20me%20arsyetime\\_2015.pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/RrGGK_Mjaft%20m%C3%AB%20me%20arsyetime_2015.pdf)

Në këtë shifër është përfshirë vetëm dhuna fizike, që nënkupton se po të përfshihej edhe dhuna ekonomike dhe psikike, shifra do të ishte dukshëm më e lartë.<sup>10</sup>

Edhe pse gratë kanë filluar ta raportojnë dhunën te Policia e Kosovës, hulumtimet kanë gjetur se edhe veprat penale të dhunës apo shkeljet e urdhërave mbrojtës nuk ndiqen automatikisht siç është e paraparë me ligj. Kjo për shkak të diskriminimit mbi baza gjinore që ndodhë si në polici, poashtu edhe në gjyqësor.<sup>11</sup> Ndonëse gratë janë vetëdijësuar për të drejtat e tyre dhe kanë filluar t'i raportojnë edhe shkeljet nga ana e institucioneve tek instancat më të larta duke parashtruar ankesa ose padi për shkeljet ligjore dhe profesionale, kërkesat e tyre për drejtësi mbeten të pareaizuara. Kjo ka të bëjë me mungesën e vullnetit institucional që rastet e shkeljeve nga ana e zyrtarëve të tyre të ndiqen dhe ndëshkohen.

Sistemi i rregullimit disiplinor si në kuadër të policisë, poashtu edhe në kuadër të gjyqësisë, nuk është efektiv edhe pse është funksional. Kjo nënkupton se ekzistojnë mekanizmat mbikëqyrës si të tillë, por që profesionalizmi dhe përkushtimi i tyre lë shumë për të dëshiruar.

Për shkeljet që bëhen nga zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, organi hetues është Inspektoriati Policor. Ky institucion i pranon ankesat nga qytetarët dhe nëse ka dyshime për vepër penale, ankesat trajtohen nga Inspektoriati Policor i Kosovës. Pas përfundimit të hetimeve, në bashkëpunim me prokurorinë merret vendimi se a do të ngritet akuzë për rastin në fjalë. Ndërsa, nëse Inspektoriati Policor vlerëson se rasti nuk përbën shkelje penale nga zyrtarët policorë, vepra e denoncuar përmes ankesës klasifikohet si shkelje disiplinare dhe përcillet për trajtim te Drejtoria për Hetime dhe Verifikim të së Kaluarës (DHVK), e cila funksionon brenda Policisë së Kosovës (ky organ

---

<sup>10</sup> Luljeta Aliu, Ndryshimi i Ligjit për Familjen, f. 12.

<sup>11</sup> Agjencioni për Barazi Gjinore, 2008, fq. 91. <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/ABGJ%20RAPORTI%20DH%20FAMILJE%20Shqipe.pdf>

më herët është quajtur Drejtoria për Standarde Profesionale). Kjo Drejtoria zakonisht e kthen lëndën në stacionin policor, ku ka ndodhur shkelja, dhe aty pastaj rasti i zyrtarit policor, ndaj të cilit qytetarët janë ankuar, trajtohet nga kolegët e tij. Ndaj vendimit të stacionit policor dhe DHVK-së qytetarët mund të ankohen në Komisionin për Ankesa brenda Policisë së Kosovës. Ky komision është shkalla më e lartë ku qytetarët mund të ankohen brenda policisë ndaj shkeljeve të zyrtarëve policorë.

Gjyqësori në Kosovë është i organizuar në tri shkallë. Shkalla e parë është Gjykata Themelore, shkalla e dytë është Gjykata e Apelit dhe shkalla e tretë Gjykata Supreme. Gjykata Themelore ka 7 degë në shtatë rajone, të cilat kanë nëndegët e tyre. Ndaj vendimeve të Gjykatës Themelore qytetarët mund të ankohen në Gjykatën e Apelit, e cila funksionon vetëm në Prishtinë. Ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit qytetarët e kanë mundësinë të ankohen në Gjykatën Supreme. Ndërsa nëse qytetarët ankohen ndaj gjyqtarëve për shkak të sjelljeve të pahijshme të tyre, atëherë ankesat drejtohen te “Autoriteti Kompetent” i përcaktuar sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve që ka hyrë në fuqi në Dhjetor 2018.<sup>12</sup>

Fatkeqësisht, në Kosovë është instaluar një kulturë institucionale e mosndëshkimit të kolegëve, edhe nëse ata kanë bërë shkelje të detyrës zyrtare. Kjo situatë i lë të gjithë qytetarët të pambrojtur, por më së shumti i dëmton grupet e marginalizuara dhe të cenueshme, sidomos gratë të cilat përbëjnë gjysmën e popullsisë. Diskriminimi gjinor ndaj grave brenda institucioneve është tregues i mungesës së profesionalizmit dhe llogaridhënies brenda institucioneve të rendit dhe ligjit.


Dhuna ndaj grave ka bërë që këto të fundit shpeshherë të shohin divorcin

---

<sup>12</sup> Ligji Nr. 06/L – 057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, online në <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18336>

si rrugëdaljen e vetme. Sipas të dhënave administrative për vitin 2018 nga Gjykatat Themelore të Kosovës, janë grumbulluar gjithsej 999 fleta statistikore për shkurorëzime.<sup>13</sup> Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), tregojnë se në Kosovë ka rritje të numrit të divorceve.

Shifra e lartë e dhunës në familje është dëshmuar edhe gjatë grumbullimit të intervistave të realizuara me gratë e divorcuara, prej të cilave gjysma e tyre kanë përjetuar dhunë fizike. Gani Leci, mbrojtës i viktimave, deklaroi se dhuna është e shprehur në forma të ndryshme: rrahje, tortura, kafshime, ndrydhje, tërheqje e flokëve dhe sulme të ndryshme. “Në vitin 2018, gjithsej 225 raste të dhunës në familje janë paraqitur te Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave [vetëm në Gjilan]”.<sup>14</sup> Përkundër faktit se reth 50% e grave të intervistuar kanë përjetuar dhunë fizike, vetëm 67% prej tyre e kanë raportuar atë.



<sup>13</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, “Statistikat e Shkurorëzimeve,” 2018, marrë nga, <http://ask.rks-gov.net/media/4946/statistikat-e-shkurorëzimeve-2018-shqip.pdf>

<sup>14</sup> Intervistë Personale, Gani Leci, Mbrojtës i Viktimave, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave.

Një numër i konsiderueshëm i grave të divorcuara kanë theksuar dhunën fizike si një ndër shkaktarët kryesorë të divorcit. Shpeshherë gratë janë të papunësuar dhe nuk kanë mundësi financiare të paguajnë një banesë. Edhe nëse gruaja ka përjetuar dhunë në familje, ajo detyrohet të largohet nga shtëpia apo banesa e përbashkët, që është shumë e dëmshme për situatën e saj. Policia, prokuroria dhe gjykatat i udhëzojnë gratë të shkojnë në strehimore të grave, edhe pse në këto raste do të duhej që kryesi i dhunës në familje të largohet nga shtëpia apo banesa.

Në shumicën absolute të vendeve europiane, në raste të dhunës, burri duhet ta lëshojë shtëpinë dhe nuk është aspak e rëndësishme për gjykatën se ku do të qëndrojë përkundrazi, gjykata përpiqet që viktimat e dhunës të mos ngarkohen me situata tjera të pakëndshme. Ndërsa në Kosovë ndodhë zakonisht e kundërta. Gruaja largohet prej shtëpisë dhe detyrohet të shkojë në strehimore të grave, ku kushtet janë tepër të rënda dhe strehimoret vazhdimisht “përballen me sfida të ndjeshme në sigurimin e fondeve të qëndrueshme”.<sup>15</sup> Sipas prokurores, Leonora Shemsiu-Kadriu, “ka mungesë të programeve dhe strategjive shtetërore për t’i integruar gratë që kanë përjetuar dhunë. Ne i kemi dërguar gratë në kurse të ndryshme përmes zyrës për mbrojtjen e viktimave, mirëpo kjo nuk mjafton.”<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup> Rrjeti i Grave të Kosovës, „Analiza Gjinore e Kosovës”, fq.25, onlinë në <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

<sup>16</sup> Intervistë Personale, Leonora Shemsiu-Kadriu, Koordinatore e Dhunës për Familje.



## KORNIZA LIGJORE

Në Kosovë, gratë ende përballen me vështirësi për të siguruar qasjen e tyre në pronë. Korniza ligjore ekzistuese ju garanton grave dhe vajzave të drejtën në trashëgimi (prona e trashëguar nga prindërit) dhe të drejtën në pronën e përbashkët bashkëshortore (prona apo pasuria e krijuar gjatë martesës). Mirëpo, në praktikën gjyqësore këto të drejta nuk përfillen. Me dinamikën e jetës dhe zhvillimeve shoqërore të viteve të fundit, janë rritur edhe rastet e shkurorëzimeve. Shkurorëzimi, përpos që ka për pasojë prishjen e martesës, gjithashtu sjell si nevojë edhe ndarjen e pasurisë së përbashkët, vendimet për alimentacion (pagesat fëmijë) dhe mbajtje financiare të bashkëshortit/es (ushqimia).

Meqë shoqëria kosovare ende funksionon sipas parimeve të patriarkatit, sigurimi i qasjes së grave në të drejtat ligjore nuk është fare i lehtë. Me patriarkat nënkuptohet një sistem i marrëdhënieve shoqërore, vlerave mbizotëruese, normave dhe mënyrave të jetesës dhe veprimeve, i cili është i kontrolluar dhe përfaqësuar nga baballarët dhe burrat. Shoqëria nuk mund t'i ikë ndikimit të botëkuptimit të rrethit në të cilin është rritur dhe i cili ndikon në mënyrë të pavetëdijshme në secilin nga veprimet tona. Secili anëtar i shoqërisë i bartë në mënyrë të pavetëdijshme me vete reliktet e socializimit të tij në një rreth të caktuar, relikte të cilat shpesh ndikojnë fare pa u vërejtur edhe në mënyrën tonë të të menduarit dhe vepruarit.

Mendësia patriarkale, jo vetëm në Kosovë, por në mbarë botën ka pasur për pasojë shkeljen dhe shtypjen e grave dhe vajzave. Gratë kanë fituar shumë më vonë të drejtën në votë, të drejtën për shkollim, për pavarësim ekonomik etj. Edhe vetë qasja në drejtësi për gratë është ndikuar nga sistemi patriarkal i të menduarit, i cili gruan nuk e sheh si të barabartë, por e trajton si më pak të vlefshme. Kjo nënkupton se gratë mendohet të mos kenë të drejtë të kenë të drejtat e njëjta si burrat. Një shoqëri patriarkale të drejtat e grave i dallon

nga të drejtat e burrave, dhe nëse një grua bën veprimet e njëjta si burri, ajo ka bërë shkelje të normave shoqërore dhe paragjykohet si e pamoralshme apo e çmendur. Ky është një sistem vlerash të diskriminuara gjinore. Në një sistem të tillë, një grua që për vete i cakton të njëjtat të drejta sikur burrat, ajo konsiderohet e pavlerë për atë shoqëri, e papranueshme për rrethin.

Kjo mendësi, fatkeqësisht, mbizotëron te një pjesë dërmuese e shoqërisë kosovare, përfshirë këtu edhe vetë gratë. Por sado që kjo të jetë e dëmshme, asnjëherë nuk mund të shkaktojë dëmin, të cilin janë në gjendje ta shkaktojnë institucionet. Institucionet ndikohen nga shoqëria dhe paragjykimet e tyre. Mirëpo gjykimi i tyre është shumë i rëndësishëm, sepse luan një rol vendimtar në vendimmarrjen e tyre profesionale. Raportet rreth të drejtave të grave dhe dhunës në familje në Kosovë kanë dëshmuar se nëpër institucione, zyrtarët shpeshherë haptazi dhe me veprime konkrete e shprehin mendësinë e tyre patriarkale gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, duke bërë shkelje ligjore.

Dëmin më të madh e përjetojnë gratë për shkak të vendimeve gjyqësore të padrejta për shkak të mungesës së profesionalizmit apo edhe mendësisë patriarkale të gjyqtarëve. Kësisoj, të drejtat e grave për qasje të barabartë në drejtësi, në pronë dhe pasuri të përbashkët si dhe në të drejtën për mbajtje financiare, i gjykojnë sipas strukturës së mendësisë së tyre të trashëguar patriarkale. Për fat të keq, kjo ka ndikuar që edhe vetë dispozitat ligjore rreth këtyre të drejtave janë interpretuar gabimisht dhe i kanë dëmtuar gratë gjatë proceseve gjyqësore. Për shumë burra kosovarë, sidomos për policë, gjyqtarë apo prokurorë, ka qenë e pakonceptueshme e drejta e barabartë e grave, aq më pak në pasurinë e përbashkët, sepse gruaja është kuptuar vetëm si ndihmëse e burrit. Prandaj edhe vlera e punës së grave me fëmijë në shtëpi nuk është konsideruar si e barasvlerëshme me punën që burrat bëjnë jashtë shtëpisë.

Për këtë arsye, Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi INJECT, e ka konsideruar të nevojshme që të përmbledhë dhe t'i elaborojë në një kornizë të shkurtë ligjore

dispozitat ligjore përkitazi me pasurinë e përbashkët dhe mbajtjen financiare dhe martesore. Kjo është bërë me synimin që gratë dhe vajzat të informohen sa më drejtë në lidhje me të drejtat e tyre pronësore të krijuara gjatë martesës. Qëllimi kryesor është që gratë të jenë të vetëdijshme për ligjet ekzistuese dhe të marrin guximin dhe informatat e nevojshme për të kërkuar pjesën e pasurisë së përbashkët që ju takon në bazë të punës së tyre. Grave, sipas Ligjit për Familjen ju takon gjysma e pasurisë së përbashkët për shkak të rritjes dhe edukimit të fëmijëve dhe punëve tjera në shtëpi. Pasuria e përbashkët ka mundur të krijohet vetëm me krijimin e mundësisë që njëri bashkëshort të punojë jashtë ekonomisë familjare, derisa gruaja kryer punët brenda ekonomisë familjare, në shtëpi. Vlera e punës brenda dhe jashtë ekonomisë familjare, konsiderohet me ligj dhe është e barabartë. Kjo është arsyeja që ligji edhe e ka përcaktuar se grave ju takon gjysma e pasurisë, sepse ligji punën në shtëpi të grave e konsideron si gjysmën e vlerës së pasurisë së përbashkët. Nëse gratë e kërkojnë gjysmën e pasurisë që ju takon sipas ligjit, këtë nuk i'a marrin askujt, pra nuk i'a marrin burrit gjysmën, por thjesht e kërkojnë pjesën e tyre, të drejtën e tyre.

Fatkeqësisht, deri më sot, sikurse gjykatat dhe shoqëria në përgjithësi, poashtu edhe vetë gratë, nuk e kanë trajtuar vlerën e punës së gruas në shtëpi si të barabartë me vlerën e të ardhurave materiale të burrit. Kjo ka rezultuar në dëm material dhe pronësor të grave, të cilat kanë kaluar dhe ende kalojnë në procedura të shkurorëzimit dhe të ndarjes së pasurisë. Kjo kornizë ligjore në vijim do të diskutojë të drejtën e pronësisë me më shumë subjekte, duke vazhduar pastaj me elaborimin e pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare apo martesore të bashkëshortit.

## E DREJTA E PRONËSISË ME MË SHUMË SUBJEKTE

E drejta e pronësisë paraqet njërin ndër institutet juridike më të rëndësishme të së drejtës civile në përgjithësi, respektivisht institutin më të rëndësishëm të së drejtës sendore në veçanti.<sup>17</sup> Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.<sup>18</sup>

Mbi një send të caktuar mund të kenë të drejtën e pronësisë (përdorimit, shfrytëzimit dhe disponimit) dy e më shumë persona, dhe kjo ndryshe kuptohet si e drejta e pronësisë me më shumë subjekte. Format e pronësisë me më shumë subjekte janë *pronësia e përbashkët*, *bashkëpronësia* dhe *pronësia etazhe*. Për qëllimet e kësaj kornize ligjore do të diskutohet kryesisht *pronësia e përbashkët*.

### **Kuptimi i pronësisë së përbashkët dhe dallimi nga bashkëpronësia**

Pronësia e përbashkët është e drejta e pronësisë së më shumë personave në të njëjtin send sipas pjesëve që nuk janë të caktuara as realisht e as idealisht, por që janë të caktueshme. Me pronësinë e përbashkët nënkuptohet pronësia e disa personave mbi një send të caktuar. Pronësia e përbashkët rregullohet edhe me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Kosovës (në vazhdim LPDTS), i cili thekson se, nëse disa persona kanë të drejtë pronësie mbi një send në atë mënyrë që pjesët e tyre nuk janë të caktuara, atëherë ata janë pronarë të përbashkët.<sup>19</sup> (është ky citim apo vetëm interpretim i lirë i tekstit

<sup>17</sup> Shih Aliu, Abdullah., E drejta sendore (pronësia) 2009, Fq.75

<sup>18</sup> Shih nenin 18 par.1 të Ligjit Nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, në vazhdim LPDS.

<sup>19</sup> Shih nenin 77 të Ligjit Nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, në vazhdim (LPDTS).

të ligjit, përndyshe duhet futur ne thonjëza.)

Për dallim nga pronësia e përbashkët, bashkëpronësia si institut juridik ekziston kur dy ose më shumë persona kanë të drejtë pronësie mbi një send, secili sipas pjesëmarrjes së vet. Bartësit e të drejtës së bashkëpronësisë kanë të drejtën e pronësisë mbi sendin në bazë të pjesës alikuote (ideale) që e përbëjnë tërësinë e sendit, e cila pjesë alikuote mund të shprehet në përqindje psh: 10%, 15% ose mund të shprehet si psh: 1/2 ose 1/3 etj.<sup>20</sup>

Këtu mund të cekim disa veçori apo karakteristika të cilat e dallojnë pronësinë e përbashkët nga bashkëpronësia, siç mund të jenë:

- a. Te pronësia e përbashkët pronarët nuk e dinë pjesën e tyre të pronësisë, nuk i dinë pjesët e tyre ideale mbi sendin, pra sendi konsiderohet pronësi e përbashkët dhe pronarët nuk mund të disponojnë lirisht me sendin derisa të bëhet pjesëtimi dhe ndarja e tij, titullari i sendit mund të disponojë me sendin vetëm në favor të pronarit tjetër të përbashkët e assesi në raport me personat e tretë.
- b. Ndërsa te bashkëpronësia, pronarët i dinë pjesët ideale të tyre mbi sendin, të cilat ju takojnë, ata kanë të drejtën e pronësisë mbi sendin në bazë të pjesëve ideale që e përbëjnë sendin, si dhe këtu titullari i sendit mund të disponojë lirisht më pjesën e tij ideale edhe pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë.

Pronësia e përbashkët njihet në tri forma të ndryshme:

- a. Pronësia e Përbashkët e Bashkëshortëve;
- b. Pronësia e Përbashkët e Familjeve të mëdha dhe
- c. Pronësia e Përbashkët e Bashkëtrashëgimtarëve mbi sendet e masës trashëguese.

---

<sup>20</sup> Po aty, fq.89.

Ligji për Familjen, në dispozitat ligjore në lidhje me pronësinë e përbashkët, thekson që dispozitat lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve të një martese ligjërish të regjistruar, zbatohen në mënyrë analoge edhe për marrëdhëniet pronësore të personave në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore).<sup>21</sup>

Ligji për Familjen i Kosovës bashkëjetesën e ka barazuar në disa çështje edhe me martesën ligjore: “Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) është e barabartë me statusin martesor nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke dhe të drejtat pasurore ashtu siç është specifikuar me ligj”.<sup>22</sup>

## MARRËDHËNIET PASURORE TË BASHKËSHORTËVE

Bashkëshortët gjatë jetesës së tyre të përbashkët krijojnë të mira materiale, të cilat atyre do të ju shërbenin për kryerjen e shërbimeve të caktuara si dhe për vetë ekzistencën e tyre. Nga këto të mira materiale burojnë të drejtat dhe detyrimet për bashkëshortët, të cilat mund të jënë të karakterit personal-pasuror dhe të karakterit pasuror.

Të drejtat dhe detyrimet personale-pasurore janë me karakter pasuror, por të lidhura me subjektin e caktuar. Këto të drejta dhe detyra janë të lidhura ngushtë me personalitetin e çdo bashkëshorti dhe rrjedhimisht nuk mund t'i kalojnë ndonjë personi tjetër me ndonjë veprim juridik, as për së gjalli të subjekteve (*inter vivos*) e as në rast vdekje (*mortis causa*).<sup>23</sup> Prandaj ato quhen të drejta pasurore, por personale, përkatësisht pasurore-personale. Të drejta të kësaj natyre janë: a) mbajtja (ushqimi) i bashkëshortit të pasiguruar, b) mbajtja (ushqimi) i familjes, c) përgjegjësia e bashkëshortit për detyrimet e

---

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Shih nenin 39, par.2 te LFK-se.

<sup>23</sup> Shih Aliu, Abdullah dhe Gashi Haxhi, E drejta familjare 2007, fq. 135.

krijua rreth plotësimin të nevojave të bashkësisë martesore dhe familjare.<sup>24</sup>

Ndërsa të drejtat dhe detyrat të cilat janë të karakterit vetëm pasuror përbëjnë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve quhet regjim pasuror.<sup>25</sup> Me regjimin pasuror të pasurisë së bashkëshortëve në bashkëjetesë kuptojmë tërësinë e normave juridike që rregullojnë në një mënyrë anë marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve dhe në anën tjetër marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve me personat tjerë.

Marrëdhëniet pasurore rregullohen me dispozitat e Ligjit për Familjen të Kosovës (LFK) me nenet 45-58, ku neni 45 cakton parimet lidhur me marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve, duke vënë theksin në pronësinë e përbashkët të pronës së fituar pas lidhjes së martesës, dhe duke precizuar se pasuria e bashkëshortëve mund të jetë pasuri e veçantë ose e përbashkët.

### **Pasuria e veçantë e bashkëshortëve**

Pasuria e veçantë e bashkëshortëve është pasuria të cilën bashkëshortët e kanë pasur qysh para lidhjes së bashkëjetesës, pra është ajo pasuri e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së bashkëjetesës. Pasuri e veçantë konsiderohet edhe ajo pasuri, e cila është fituar gjatë kohëzgjatjes së bashkëjetesës përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore, por jo me punë.

Me dispozitat e nenit 46 të LFK-së rregullohet në mënyrë të hollësishme pasuria e veçantë e bashkëshortëve. Pasuria e veçantë dallohet nga pasuria e përbashkët sipas mënyrës së krijimit dhe kohës së krijuar të asaj pasurie në raport me lidhjen apo krijimin e bashkëjetesës. Si pasuri e veçantë e bashkëshortit është ajo pasuri që ai/ajo e ka të regjistruar në emër të vet

---

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Shih Podvorica, Hamdi E drejta Familjare 2006, fq.239.

ose ose ende nuk ka arritur ta regjistrojë, por është e fituar para lidhjes së martesës.<sup>26</sup> Bashkëshortët vazhdojnë gjatë gjithë jetës së tyre të jenë titullar individual të pasurisë së tyre të veçantë.<sup>27</sup> Bashkëshortët, secili prej tyre, gëzojnë pavarësi të plotë në administrimin, posedimin dhe disponimin e pasurisë së veçantë gjatë gjithë kohës së bashkëjetesës, dhe se ata nuk kanë nevojë që për administrimin, posedimin dhe disponimin e pasurisë së veçantë të kërkojnë lejen apo pëlqimin e bashkëshortit tjetër.

### Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është ajo pasuri, të cilën bashkëshortët e kanë krijuar me punë gjatë kohëzgjatjes së bashkëjetesës së tyre, përkatësisht jetës së përbashkët bashkëshortore. LFK e ka përkufizuar pronën apo pasurinë e përbashkët përmes dispozitave në nenin 47 (Pasuria e përbashkët):

1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë;
2. Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve;
3. Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.
4. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh;

Neni 47 në verzionin si më lart ka qenë në fuqi deri në janar 2019, kur përmes Gazetës Zyrtare është shpallur LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS, sipas

---

<sup>26</sup> Shih Gashi, H / Aliu, A dhe Vokshi, A - Komentari i Ligjit nr.2004/32 per Familjen I Kosoves, fq,121

<sup>27</sup> Po aty;



iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Familjen, ekspertizës ligjore dhe propozimit të dërguar në Komisionin për Legjislacion të Kuvendit të Kosoës nga Luljeta Aliu. Fatmirësisht, në Komisionin e udhëhequr nga znj. Albulena Haxhiu, kjo iniciativë ka gjetur përkrahjen e nevojshme për tu proceduar tutje për votim në Kuvend, ku edhe me 13 qershor 2018 është votuar unanimitisht nga të gjithë deputetët e pranishëm nga të gjitha partitë politike.

**Neni 47 (Pasuria e përbashkët)** i aktualizuar është ndryshuar për të shpallur të barasvlershme kontributet e të dy bashkëshortëve, pra që kontributi me të hyrat dhe të ardhurat materiale në njërën anë dhe kontributi me rritjen, edukimin e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e shtëpisë vlerësohen si të barabarta.

1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.
2. Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet:
  - 2.1. të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort;
  - 2.2. ndihma e bashkëshortit e afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.
3. Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm.
4. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.
5. Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.

### 6. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të përfshijë të drejtat sendore dhe të detyrimeve.

Të dy bashkëshortët mund të punojnë bashkërisht në një veprimtari të njëjtë, apo të punojnë në punë të ndryshme (p.sh. burri në marrëdhënie pune, ndërsa gruaja është amvise, etj.). Kontributi në fitimin e pasurisë së përbashkët mund të jetë i drejtpërdrejtë (fitimi nga marrëdhënia e punës, fitimi i ndërmarrësit, pensioni) apo indirekt, kur puna e njërit bashkëshort shprehet në ndihmën ndaj bashkëshortit tjetër, në punët e ndryshme që i kontribuojnë bashkësisë familjare, siç janë, edukimi dhe rritja e fëmijëve, mirëmbajtja e rrobave, përgatitja e ushqimit, etj.<sup>28</sup>

Pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve e përbëjnë të gjitha sendet dhe të drejtat e tjera subjektive me karakter pasuror, të fituara me punë gjatë jetës së përbashkët. Duke respektuar parimin e unitetit të pasurisë, konsiderojmë se bashkëshortët në bashkësi kanë vetëm një pasuri të përbashkët, e cila është fituar gjatë jetës së përbashkët martesore dhe si e tillë ajo ju takon në mënyrë proporcionale në bazë të kontributit të tyre lidhur me fitimin e saj, që do të thotë se nëse nuk ka pasur pasuri të veçantë ndonjëri prej tyre, atëherë ju takon në pjesë të barabarta. Gjithashtu dhuratat, të cilat u janë dhënë bashkëshorteve nga personat e tretë pa destinim të caktuar për ndonjërin prej bashkëshortëve, por me qëllimin e rritjes së pasurisë së tyre, konsiderohet pasuri e përbashkët e bashkëshortëve. Edhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me një vendim të saj ka konstatuar se sendet të cilat bashkëshortët i marrin në ditën e kurorëzimit nga personat e tretë si dhuratë, i takojnë edhe njërit edhe tjetrit bashkëshort, sepse jepen me qëllim të themelimit të familjes së re dhe në funksion të një jete më të lehtë<sup>29</sup>. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve konsiderohet edhe pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkarisht përmes lojrave të fatit. Sipas LFK-së, Pasuria e përbashkët mund të përfshijë edhe të

---

<sup>28</sup> Bahtiri, Bedri Punimi i Doktoratures - Aspektet Nacionale Nderkombetare të Regjimit Pasuror Martesor të bashkëshortëve, fq. 122.

<sup>29</sup> Vendimi Rev.nr.268/2006, të datës 24.12.2008 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

drejtat sendore dhe të detyrimeve.<sup>30</sup> Ndërsa LFK është *lex specialis* dhe vlen para të gjitha ligjeve tjera. Kjo nënkupton se nëse me LFK një çështje është e rregulluar me ligj, atëherë para të gjitha ligjeve tjera mbizotëron interpretimi që i jepet çështjes sipas dispozitave të LFK-së.

Puna si kusht ligjor për fitimin e pasurisë së përbashkët duhet të shikohet në një kuptim më të gjërë, pra jo vetëm si kategori ekonomike në bazë të **së cilës** krijohen vlera të reja. Puna duhet të kuptohet si aktivitet dhe kontribut për plotësimin e nevojave të përbashkëta martesore dhe familjare<sup>31</sup> siç janë rritja dhe edukimi i fëmijëve, mirëmbajtja e shtëpisë, përgaditja e ushqimit, përkujdesja ndaj prindërve etj. Rrjedhimisht, bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.

Ndarja e pasurisë së përbashkët dhe përcaktimi i kontributit të secilit bashkëshort në krijimin e saj është punë shumë e ndërlikuar për gjykatën. Gjykata e cila bën ndarjen e pasurisë së përbashkët niset nga parimi i barazisë së bashkëshortëve dhe supozimi se bashkëshortët janë pronarë të barabartë të sendeve në pronësi të përbashkët, çka do të thotë se gjykata mënyrën tjetër të ndarjes nuk e bën sipas detyrës zyrtare, por vetëm me propozimin e bashkëshortit, i cili pretendon se ka të drejtë në pjesë më të madhe në pronësinë e përbashkët. Me rastin e ndarjes së pasurisë së përbashkët duhet doemos të merren parasysh edhe borxhet e pasurisë së përbashkët, të cilat do të llogariten në pjesën e secilit bashkëshort. Në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve hyn edhe banesa e blerë me kredi nga njëri bashkëshort para lidhjes së martesës, por kjo në rastin kur regjistrimi i të drejtës së pronësisë është kryer pas lidhjes së martesës dhe me kushtin se pagesën e kredisë për fitimin e banesës e kanë marrë përsipër të dy bashkëshortët.

---

<sup>30</sup> LFK neni 47 paragrafi 2.

<sup>31</sup> Podvorica, Hamdi: E drejta Familjare fq, 243.

## REGJIMI PASUROR MARTESOR

Martesa si një ndër pjesët më të rëndësishme të së drejtës familjare ka qëllime të shumta, të cilat duhen përmbushur për t'u konsideruar e vërtetë. Këtu veç tjerash, bashkëshortët krijojnë pronësi dhe pasuri të caktuar me punën e tyre të përbashkët apo të veçantë. Regjimi pasuror martesor përbën tërësinë e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve në lidhje me pasurinë që fiton secili prej tyre gjatë martesës, si dhe marrëdhëniet që vendosen midis tyre dhe personave të tretë dhe marrjes përsipër të detyrimeve në lidhje me pasurinë e krijuar gjatë martesës.

Sendet, të cilat janë fituar me punë gjatë martesës përbëjnë objektin e pronësisë së përbashkët, titullar të së cilës janë të dy bashkëshortët. Kontrata, me të cilën bashkëshorti gjatë martesës ka tjetërsuar pasurinë e fituar në bashkësinë martesore, bie në kundërshtim me nenin 49 të Ligjit për Familjen, me të cilën është parashikuar se me pasurinë e përbashkët, bashkëshortët gjatë martesës administrojnë dhe disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje.

Të drejtën e pronësisë së përbashkët në sendet e paluajtshme, bashkëshortët e fitojnë me regjistrimin në librat publik të tokës (*iustus titulus*). E drejta e pronësisë së përbashkët në sendet e paluajtshme regjistrohet në librat publik në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara. Njëri bashkëshort, në bazë të kontratës me bashkëshortin tjetër, mund të autorizohet të vetadministrojë dhe të vetdisponojë me pasurinë e përbashkët. Në bazë të një autorizimi të tillë, në të shumtën e rasteve, në viset rurale zakonisht është burri ai që regjistrohet në librat publik si pronar kryesor i paluajatshmërisë. Pavarësisht kësaj, vlen supozimi ligjor se regjistrimi është kryer në emër të të dy bashkëshortëve.

Aktet e kryera nga njëri bashkëshort në pasurinë e përbashkët pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër janë të pavlefshme, në qoftë se u përkasin sendeve të

paluajtshme, ose sendeve të luajtshme që regjistrohen në regjistrat publik. Ndërsa, nëse është fjala për të mirat tjera materiale në sendet e luajtshme ato janë të vlefshme. Në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve hyn edhe banesa, të cilën njëri bashkëshort e ka blerë me kredi apo me çdo formë tjetër para lidhjes së martesës, nëse regjistrimi i të drejtës së pronësisë është kryer pas lidhjes së martesës dhe kredia paguhet gjatë martesës.

Në qoftë se bashkëshorti e tjetëron sendin nga pasuria e përbashkët pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, kontrata e tillë është në kundërshtim me dispozitën detyruese dhe është e pavlefshme. Në qoftë se njëri bashkëshort lidh kontratë në dëm të pasurisë së përbashkët pa autorizimin e bashkëshortit tjetër, kjo kontratë e obligon bashkëshortin tjetër vetëm nëse ai pajtohet me një gjë të tillë ose e autorizon atë në mënyrë plotësuese. Kontrata, e cila në mënyrë plotësuese nuk është autorizuar, është e pavlefshme (nul).

### **Pjesëtimi me marrëveshje i pasurisë së bashkëshortëve**

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të ndahet me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve ose sipas marrëveshjes së përbashkët mes tyre. Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve në çdo kohë mund të shndërrohet në pasuri të veçantë në bazë të marrëveshjes midis bashkëshortëve përmes propozimit në procedurë jokontestimore, ndërsa në rast se bashkëshortët nuk mund të arrijnë marrëveshje lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët, atëherë zgjidhja gjendet përmes padisë në procedurë kontestimore. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e marrëdhënieve familjare – juridike, të cilat janë marrëdhënie statusore, në rast kontesti, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tyre, për këto marrëdhënie zhvillohet procedurë e veçantë. Ndarjen e pasurisë së përbashkët mund ta kërkojnë edhe trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur. Kërkesën për ndarje mund ta paraqesë edhe personi i tretë, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve në situatën kur kërkesat e veta ndaj bashkëshortit nuk mund t'i realizojë nga pasuria e tij e veçantë.

Bashkëshortët edhe gjatë kohëzgjatjes së martesës mund të kryejnë ndarjen e pasurisë së përbashkët, të cilën e kanë fituar deri në momentin e ndarjes.

Ndarja me marrëveshje, sipas rregullit, është mënyra më e mirë për bashkëshortët, pasi ata kanë marrë pjesë bashkërisht në fitimin e pasurisë dhe e dinë më së miri se si duhet ta ndajnë atë. Kjo marrëveshje duhet të arrihet në formën me shkrim. Ndarja me marrëveshje e pasurisë së përbashkët në rastin e shkurorëzimit sipas marrëveshjes së bashkëshortëve është e detyrueshme dhe është pjesë përbërëse e marrëveshjes për shkurorëzim. Tjetërsimi i pasurive të përbashkëta të paluajtshme duhet të bëhet gjithmonë me pëlqimin e të dy bashkëshortëve.

Pasuria e përbashkët mund të ndahet gjatë kohëzgjatjes së martesës dhe pas pushimit të martesës. Në të shumtën e rasteve ndarja bëhet pas pushimit të martesës, por kjo nuk do të thotë që ekzistojnë pengesa që ajo të kryhet me kërkesën e personave të autorizuar edhe gjatë kohës që zgjat martesa.

Kontrata mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve duhet të lidhet në formën me shkrim. Në bazë të kësaj kontrate e drejta e bashkëpronësisë (pronësisë) për paluajtshmërinë fitohet me regjistrim në librin publik. Marrëveshja për ndarjen e pasurisë së përbashkët e fituar në martesë, të cilën palët e kanë lidhur në rastin e shkëputjes së martesës dhe që është shënuar në procesverbalin për shqyrtimin kryesor, paraqet kontratë të vlefshme për ndarjen e pasurisë së përbashkët. Kur mes bashkëshortëve ekziston marrëveshja për ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe kjo është e lidhur në formën e duhur, nuk mund të kërkohej që për ndarjen e pasurisë së përbashkët të vendos gjykata.

## Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes

Në rast se bashkëshortët nuk janë marrë vesh ndryshe, gjykata pasurinë e përbashkët duhet ta ndajë në pjesë të barabarta. Sistemi i theksuar i ndarjes së pasurisë së përbashkët në pjesë të njëjta vlen si supozim. Çdonjëri bashkëshort, i cili nuk është i kënaqur me ndarjen në pjesë të njëjta, mund të kërkojë që të vërtetohet pjesa e tij më e madhe. Barra e të provuarit të pjesës më të madhe bie mbi bashkëshortin që rrëzon supozimin e theksuar për pjesët e njëjta. Neni 47 thotë se pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta. Neni 54 thotë se në rast mosmarrëveshjeje, gjykata e vendos pjesëtimin e pasurisë së përbashkët. Sipas nenit 55, një pjesë më të madhe mund të kërkojë njëri bashkëshort vetëm nëse ka pasuri të veçantë.

Kjo pjesë rregullohet në LFK me **nenin 54 (Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes):**

1. Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.
2. Gjkata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni.

Gjkata nuk është e autorizuar që sipas detyrës zyrtare të përcaktojë madhësinë e pjesës së bashkëshortëve në pasurinë e përbashkët, por vetëm sipas

paditësit të legjitimuar aktiv. Madhësinë e pjesës së bashkëshortit gjykata do ta përcaktojë sipas masës së pasurisë së theksuar në padi. Bashkëshortët në të vërtetë mundën që një pjesë të masës pasurore ta ndajnë me marrëveshje, sikundër të kërkojnë me padi ndarjen e masës tjetër të pasurisë e cila hyn në pasurinë e përbashkët të fituar.

Pasi kryhen llogaritjet, gjykata nxjerr vendim për ndarjen e pasurisë në pjesë që i takojnë secilit në bazë të kontributit të dhënë gjatë bashkësisë martesore, por kjo ndodh përherë nëse bashkëshortët kanë parashtruar një kërkesë të tillë. Nga ky moment pushon së ekzistuari pasuria e përbashkët mes bashkëshortëve dhe secili prej tyre bëhet bashkëpronar në pasurinë e përbashkët. Ato pjesë mund të jenë të njëjta (50% - 50%), por mund të jenë dhe të ndryshme, (p.sh 70% - 30%), në varësi të kontributit të caktuar në fitimin e pasurisë së përbashkët. Praktika tregon, se pas nxjerrjes së vendimit për përcaktimin e pjesëve të pronësisë së përbashkët, bashkëshortët vetëzbatojnë ndarjen fizike të sendeve dhe të drejtave. Por nëse ata nuk mund të merren vesh, ndarja fizike e sendeve dhe e të drejtave zbatohet nga gjykata, e cila nëpërmjet vendimit gjyqësor ndan sendet e caktuara në pronësi dhe mbajtje, në tërësi apo në pjesën e caktuar për secilin bashkëshort. Në lartësinë e pjesës së bashkëshortëve në pasurinë e përbashkët me ndikim janë, nën kushte të caktuara, edhe sendet e futura në bashkësi nga shitja e pasurisë së paluajtshme të njërit prej tyre dhe të pasurisë së dhënë me qira personave të tretë.

Bashkëshortja, e cila nuk ka qenë e punësuar dhe nuk ka realizuar të hyra në të holla konsiderohet se ka kontribuar në fitimin e pasurisë gjatë bashkësisë martesore me edukimin e fëmijëve, në kryerjen e punëve shtëpiake, kujdesi për pasurinë dhe format e tjera të punës dhe të bashkëpunimit, të cilat kanë konkluduar në administrimin dhe rritjen e pasurisë së përbashkët. Gjukata, edhe kur kartela e kursimit është hapur nga njëri bashkëshort dhe në të ka depozituar të holla vetëm ai, nuk mund të të nxjerrë përfundimin se bëhet fjalë për pasurinë e veçantë të atij bashkëshorti.



## Përcaktimi i pjesëve

Nëse nuk janë marrë vesh ndryshe dhe nëse nuk bëhet kërkesa e njërit bashkëshort për një pjesë më të madhe se gjysma e pasurisë, atëherë gjykata pasurinë e përbashkët duhet ta ndajë në pjesë barabarta. Mirëpo, ekziston mundësia që njëri bashkëshort të mos jetë i pajtimit për ndarjen e barabartë dhe të kërkojë një pjesë më të madhe. Në këtë rast, Ligji për Familjen në **nenin 55 (Përcaktimi i pjesëve)** jep udhëzime për përcaktimin e pjesëve në rast mosmarrëveshjeje, kur gjykata e merr përsipër që të bëjë caktimin e pjesëve për secilin bashkëshort:

1. Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdorur kriteret e njëjta ashtu siç janë përcaktuar në nenin 54 (1).
2. Pjesa më e madhe e pasurisë së bashkëshortit në një send apo në të drejtën e caktuar, mund të përcaktohet nga gjykata vetëm nëse ai send ose e drejtë ekonomikisht është e pavarur në krahasim me sendet dhe të drejtat e tjera në pasurinë e përbashkët, dhe bashkëshorti për fitimin e atij sendi apo të drejte ka marrë pjesë me të hyrat nga pasuria e tij e veçantë.
3. Bashkëshorti, i cili pas pushimit të bashkësisë martesore, përmes investimit, rrit vlerën e sendeve të pasurisë së përbashkët, ka të drejtën të kërkojë nga bashkëshorti tjetër kompensimin nëse investimet kanë qenë të domosdoshme dhe të dobishme. Kompensimi do të jetë në proporcion me pjesën e tij në atë send.
4. Bashkëshorti tjetër mund të lirohet nga detyrimi i tillë nëse pranon pjesën më të madhe së pjesës të atij sendi në proporcion me investimet e bëra.

Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdorur të njëjtat kriteret që janë përcaktuar me ligj. Në paragrafin 2 theksohet kur gjykata mund të caktojë një pjesë më të madhe sesa gjysma për njërin bashkëshort, duke

përcaktuar se bashkëshorti ka të drejtë për një pjesë më madhe vetëm nëse ka pasur pasuri të veçantë. Kjo nënkupton, se bashkëshorti i cili e kërkon një pjesë më të madhe se gjysma e pasurisë së përbashkët, këtë të drejtë ai duhet ta dëshmojë përmes vertetimit të ekzistencës së një pasurie të veçantë që e ka poseduar para lidhjes së martesës.

Në të vërtetë, pjesa e bashkëshortëve në pasurinë e përgjithshme të përbashkët përcaktohet, sipas rregullit, në të njëjtën mënyrë me aktgjykimin që përcakton sa është pjesa e bashkëpronësisë së bashkëshortit. Bashkëshorti në padi shpeshherë kërkon vetëm ndarjen e sendeve të paluajtshme apo ndarjen e atyre sendeve për të cilat nuk është arritur marrëveshje nga ana e të dy bashkëshortëve. Në këto kushte, caktohet pjesa e njëjtë e bashkëpronësisë së njërit bashkëshort në të gjitha sendet dhe të drejtat e theksuara në padi, të cilat caktohen me aktgjykim. Pjesa e bashkëpronësisë në pasurinë e përbashkët të çdo bashkëshorti përcaktohet në momentin e pushimit faktik të bashkësisë martesore e jo në momentin e pushimit të martesës me shkurorëzim, fakt ky që *de facto*, paraqet pushimin e martesës. Martesa pushon më vonë (ndonjëherë edhe pas shumë viteve të pushimit faktik të bashkësisë martesore) me shkurorëzim, kur aktgjykimi për prishje të martesës, përkatësisht shkurorëzim, bëhet i formës së prerë (i plotfuqishëm). Pjesa e bashkëshortit në pasurinë e përbashkët përcaktohet në përpjesëtim të drejtë në të gjitha sendet dhe të drejtat e përfshira me padi (dhe aktgjykim).

Pas pushimit të bashkësisë martesore njëri bashkëshort mbetet shpesh mbajtës ekskluziv i sendit nga pasuria e përbashkët. Mbi këtë send bashkëshorti pronar bën investime që i kontribuojnë ose rritjes së vlerës së sendit, ose që lidhen me mirëmbajtjen e sendit. Bashkëshorti, i cili ka bërë investime dhe punë të tilla ka të drejtë të kërkojë nga bashkëshorti tjetër kompensimin e shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme, me përpjesëtim të pjesës së tij në atë send.

## MBAJTJA FINANCIARE

### Vështrim i përgjithshëm

Ligji për Familjen i Kosovës, çështjes së ushqimisë i kushton një kujdes të veçantë dhe e rregullon me nenet 278-336 në pjesën e tetë. LFK-ja përcakton parimet lidhur me mbajtjen financiare në nenet 278-288, pastaj mbajtjen financiare të fëmijëve, detyrimet e fëmijëve ndaj prindërve, mbajtjen martesore (mbajtja e bashkëshortit) dhe çështje të tjera që do të trajtohen në kuadër të neneve që do të komentohen.

Mbajtja financiare si institut juridik i të drejtës familjare në rend të parë është me interes për anëtarët e familjes, por është edhe në interes të vet shtetit për shkak se kur i detyruari në dhënien e mbajtjes financiare nuk është në gjendje ta bëjë këtë për shkak të mungesës së mjeteve, atëherë ky detyrim bëhet barrë e vetë shtetit. Mbajtja financiare sipas rregullit është detyrim ligjor, i cili mund të kryhet në mënyrë vullnetare nga personi, i cili është i detyruar të jap mbajtjen financiare, por në mungesë të realizimit në mënyrë vullnetare, atëherë në rrugë gjyqësore do të detyrohet dhënësi i mbajtjes të sigurojë mbajtjen financiare ndaj personit që ka të drejtën e mbajtjes financiare. E drejta e mbajtjes financiare është e drejtë subjektive e cila nuk parashkruhet<sup>32</sup>.

Prindërit janë të detyruar t'i mbajnë fëmijët e tyre në ushqim e veshmbathje, por duhet të kujdesen edhe për edukimin dhe shkollimin e tyre që kërkon angazhim të drejtpërdrejtë të mjeteve financiare të prindërve.<sup>33</sup> Detyrimi për mbajtjen financiare dhe materiale bie mbi personat, të cilët në bazë të ligjit janë të detyruar për dhënien e mbajtjes deri sa mbajtja për njërën pale është detyrim për palën tjetër është e drejtë mbajtjeje, që do të thotë titullari i të drejtës së mbajtjes - të drejtës së ushqimisë - ka të drejtë të kërkojë mbajtje nga anëtarët e familjes.

<sup>32</sup> Ligji Nr.04/L-077, LMD, Neni 363. Po aty, neni 363, pika 1.2, i LMD-së. Po aty, neni 363, pika 1.3, i LMD-së. Po aty, neni 163, pika 1.4, i LMD-së.

<sup>33</sup> Komentari i Ligjit për Familjen, faqe.575.

Paragrafi 2 i nenit 280, përcakton se prindërit edhe pse nuk kanë mjete të mjaftueshme për t'i përmbushur detyrimet e tyre personale, janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare në mënyrë të arsyeshme për fëmijët e tyre të mitur. Gjithashtu, duhet të sigurojnë mbajtje financiare edhe për fëmijët e tyre të moshës nën 26 vjeç, të cilët janë në shkollim e sipër, gjithmonë nëse ata fëmijë jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre, apo në shtëpinë e njërit prind dhe ende janë në shkollim e sipër.

Paragrafi 1 i nenit 282, përcakton se bashkëshorti është i detyruar i pari që t'i ofrojë mbajtje financiare bashkëshortit tjetër. Kështu që, detyrimi i bashkëshortit për mbajtje financiare të bashkëshortit tjetër lind nga momenti i lidhjes së martesës dhe zgjat deri sa ekziston ajo, por edhe pas shkrurorëzimit kur plotësohen kushtet e parapara me LFK. Por nën kushtet e parapara me LFK bashkëshorti mund të kërkojë mbajtje edhe pas zgjidhjes së martesës. Qëllimi i kësaj mbajtjeje është që bashkëshortit që është pa mjete materiale t'i sigurohen mjete të nevojshme për ekzistencë nga bashkëshorti tjetër. Fjalja e paragrafit 4 të nenit 282 të LFK, e rregullon rastin kur fëmiju i besohet në kujdesje bashkëshortit tjetër, atëherë bashkëshorti tjetër nuk jep mjete financiare për mbajtjen e fëmijut, sepse konsiderohet se pjesën e tij të mbajtjes financiare e përmbush duke siguruar kujdesin, edukimin dhe shkollimin e tij. Në fakt, personi i cili nuk jeton së bashku me fëmijun paguan pjesën e mbajtjes financiare në para, ndërsa bashkëshorti tjetër pjesën e vet e përmbush duke u kujdesur për fëmijun.

**Neni 285 (Shtrirja e mbajtjes)** e trajton mënyrën se si duhet të caktohet vëllimi i mbajtjes financiare, pra shuma e alimentacionit për fëmijun dhe shuma e ushqimisë për bashkëshortin/en

1. Shtrirja e mbajtjes duhet të jetë adekuate me kushtet nën të cilat ka jetuar personi që ka të drejtë në mbajtje. Në rast se personi ka jetuar në kushte të rënda, mbajtja duhet të sigurojë së paku minimumin që

nevojitet për të mbajtur një jetë të rëndomtë dinjitoze.

2. Mbajtja përfshin të gjitha kërkesat e domosdoshme për jetë, duke përfshirë të gjitha shpenzimet e domosdoshme për trajnim dhe shkollim për të fituar profesion.

Korniza ligjore aktuale e përcakton se mbajtja financiare në forme alimentacioni për fëmijët dhe në formë të ushqimisë për ish-bashkëshorten/in duhet të bëhet konform kushteve në të cilat ka jetuar personi që ka të drejtë në mbajtje. Kjo dispozitë e detyron gjykatën që të mos lejojë mashtrimet financiare dhe ekonomike në martesë.

### **Mbajtja martesore (Ushqimia)**

Neni 297, dhe nenet vijuese e rregullojnë mbajtjen financiare të bashkëshortit, respektivisht ushqiminë midis bashkëshortëve, që me këtë ligj është emërtuar edhe si mbajtje martesore. Neni 297, përcakton definimin e ushqimisë duke thënë se “ushqimia është mbajtje financiare e bashkëshortëve apo ish-bashkëshortëve”.

Dispozitat e nenit 298 i përcaktojnë rastet, në cilat ekziston detyrimi i bashkëshortit për mbajtje financiare. **Neni 298 (E drejta e bashkëshortëve në ushqimi)** parasheh:

1. Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij financiare.
2. Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit mund të refuzojë kërkesën për ushqimi, nëse ushqimia është kërkuar nga bashkëshorti me keqbesim ose nëse ai e ka braktisur bashkëshortin pa ndonjë arsye të bazuar.

Neni 298 nuk e përcakton të drejtën në mbajtje financiare (ushqimi) për ish-bashkëshortin sipas paragrafit 1 të tij. Ai paragraf nuk kërkon që patjetër duhet të ketë fëmijë nga ajo martesë për të lindur detyrimi i mbajtjes.

Neni 299 i LFK , përcakton ushqiminë e bashkëshortit për kujdesin ndaj fëmijës. Këtu përcaktohet në mënyrë parimore se bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë mbajtje (ushqiminë) nga bashkëshorti tjetër, deri sa ai do të kujdeset dhe mban fëmijën e përbashkët dhe për këtë arsye atij i bëhet e pamundur të punojë që të krijojë mjete të veta/vetanake. **Neni 299 (Ushqimia për kujdesin e fëmijt) përcakton:**

**Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijtun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punojë.**

Kjo nënkupton se nëse njëri bashkëshort duhet të përkujdeset ndaj fëmijtut të mitur dhe nuk mund ta lërë fëmijtun vetë në shtëpi gjersa të punojë për të siguruar të ardhurat për vete, atëherë ish-bashkëshorti është i detyruar të paguajë ushqiminë. Se çfarë nënkupton termi “ushqimia” bëhet e qartë në nenin 305, i cili e përcakton vëllimin e ushqimisë. **Neni 305 (Shtrirja e ushqimisë)** thotë:

**Vëllimi i ushqimisë varet nga standardi jetësor në martesë. Mbjtja e gjendjes së jetësës kërkon gjithashtu shpenzime për sigurim të përshtatshëm shëndetësor dhe shpenzimet për arsimim të mëtejshëm apo rikualifikim në përputhje me nenin 306.**

Në Kosovë deri më tani, ky nen nuk është respektuar nga gjykatat tona. Një arsye për këtë ka qenë tendenca e përgjithshme për ta mohuar përgjegjësinë për mbajtjen martesore pas prishjes së martesës. Fatkeqësisht, në shoqërinë tonë mbizotëron mendësia se ndaj bashkëshortit ke përgjegjësi vetëm gjatë

kohës sa je i martuar. Përpos kësaj, në përkeqësimin e rregullimit gjyqësor të kësaj çështjeje ka ndikuar edhe një gabim teknik në nenin 305, tek pjesa ku referohet tek neni 306 “paragrafi (3)”. Shtesa “paragrafi (3) ka qenë gabim teknik, i ngelur gjatë hartimit të ligjit. Neni 306 nuk ka një paragraf 3. Kjo pjesë është rregulluar me projektpropozimin e inicuar nga Luljeta Aliu për ndryshimin e Ligjit për Familjen, i cili ka hyrë në fuqi në Janar 2019.

Neni 299 e përcakton se ish-bashkëshorti është i detyruar të paguajë financiarisht edhe për sigurimin e jetesës së bashkëshortit, i cili përkujdeset për fëmijun e përbashkët dhe për këtë arsye nuk mund të punojë. Ndërsa neni 305 përcakton se sa duhet të jetë vëllimi i mbajtjes financiare. Neni 305 thotë se vëllimi i ushqimisë “varet nga standardi jetësor në martesë”. Përmes kësaj është synuar që të mos krijohet hapësirë për keqpërdorime nga ana e njerëzve të papërgjegjshëm dhe të mos lejohen raste, kur njëri bashkëshort i ndryshon të ardhurat e tij qëllimisht, në mënyrë që të mos detyrohet të paguajë mbajtjen martesore. Ky fenomen është i përhapur edhe në vende tjera, jo vetëm në Kosovë. Mirëpo në vendet tjera nuk pranohet një ndryshim i të ardhurave pa në arsyetim të fortë dhe të besueshëm dhe nëse vërtetohet se personi në fjalë e ka ndërmarrë me një qëllim të ikjes nga përgjegjësia këtë ndryshim, atëherë dënimi është shumë i lartë. Në Kosovë gjykatat ende nuk i hetojnë rastet e mashtrimeve ekonomike gjatë shkurorëzimit.

Neni 305 parasheh se vëllimi i mbajtjes caktohet konform standardit jetësor të familjes, pra varësisht nga kushtet ekonomike gjatë martesës, proporcionalisht duhet të jetë edhe vëllimi i mbajtjes martesore (ushqimisë), ku nuk kufizohet vetëm në sigurimin e ushqimit, por edhe sigurimin shëndetësor, shpenzimet për arsimim apo rikualifikim. Fatkeqësisht, gjykatat tona nuk e përfillin mjaftueshëm ligjin dhe dispozitat në lidhje me të drejtën në mbajtje martesore apo ushqimi ndaj bashkëshortëve. Në anën tjetër, vetë gratë nuk kanë arritur që disa të drejta të tyre ligjore t'i avancojnë duke u bashkuar në kërkesat e tyre për rregullimin dhe implementimin e duhur të kornizës ligjore në pjesët ku

preken drejtpërdrejtë të drejtat e tyre. Kjo fushë e rregullimit ligjor është e një rëndësie të veçantë sidomos për gratë, por edhe shumë e rëndësishme për mirëqenien e fëmijëve, meqë fëmijët më së afërmi e ndiejnë situatën e rënduar ekonomike të nënës. Mbi të gjitha, nëse nënës nuk i caktohet vëllimi i merituar i alimentacionit për fëmijun dhe mbajtjes martesore për të, atëherë gjykatat shpeshherë kanë vendosur që fëmijët të mos i'a japin në kujdestari nënës shkaku i kushteve të rënda ekonomike. Kjo është një situatë absurde e krijuar nga vetë sistemi i drejtësisë dhe gjykatat në Kosovë, të cilat në mënyrë të padrejtë e kanë bërë caktimin e pjesëve të pasurisë së përbashkët, por edhe të alimentacionit dhe ushqimisë, duke i lënë gratë thuajse pa pronë dhe pa mbajtje martesore pas ndarjes. Përmes caktimit të padrejtë të pjesëve është krijuar një situatë e rëndë për gratë, e cila pastaj është përdorur si argument për t'ia mohuar edhe të drejtën e kujdestarisë ndaj fëmijut.

E drejta për mbajtje martesore (ushqimia) varet nga mundësia për ta ofruar atë. Bashkëshorti detyrohet për mbajtje martesore ndaj ish-bashkëshortit aq sa janë mundësitë e tij dhe për aq sa nuk rrezikohet edhe mirëqenia e tij jetësore. Kjo rregullohet me **nenin 307 (Mundësia për të dhënë ushqimi)**:

1. Personat të cilët duke marrë parasysh të gjitha detyrimet tjera nuk janë në gjendje të japin ushqimi pa rrezikuar mbajtjen e tyre të arsyeshme, nuk janë të detyruar të japin mbajtjen.
2. Detyrimi mbetet për aq sa ata janë në gjendje të sigurojnë ushqimi.

Mirëpo edhe pas këtij neni, i cili ia lehtëson bashkëshortit detyrimin për mbajtje ndaj ish-bashkëshortit, Ligji për Familjen e ka parashikuar edhe rastin kur bashkëshorti me fëmijë mund të rrezikohet nga mungesa e të ardhurave apo mbajtjes martesore. Në nenin 309, Ligji për Familjen është përkujdesur që të evitohet mundësia e mbetjes pa të ardhura personit të shkurorëzuar. Neni 309 e përcakton se në rast pamundësie të bashkëshortit, kush do të detyrohet



të paguajë mbajtjen martesore. Kështu e përcakton **neni 309 (Rregulla e radhës së detyrimit të ushqimisë)**:

1. Detyrimin për ushqimi së pari e mban bashkëshorti i shkurorezuar.
2. Nëse dhe deri sa bashkëshorti i shkurorezuar nuk ofron alimentacion të mjaftueshëm, detyrimi kalon njëjtë sikur mbajtja financiare, në të afërmit e të paditurit sipas radhës së trashëgimisë.

Me nenin 309 kërkohet që parimisht ish-bashkëshorti është i detyruar për mbajtje martesore ndaj bashkëshortit tjetër, nëse ai/ajo është e papunë. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se nëse bashkëshorti nuk e ofron mbajtjen martesore, atëherë detyrimi kalon tek të afërmit e tij, që nënkupton se nëse përshembull burri nuk ofron alimentacion apo mbajtje martesore për gruan, atëherë detyrimi kalon te familjarët e burrit, sipas radhës së trashëgimisë.

Për ta përcaktuar detyrimin për pagesën e mbajtjes martesore dhe alimentacionit, Ligji për Familjen nën **nenin 330 (Parimet e përcaktimit të mbajtjes dhe alimentacionit) thotë**:

1. Detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit.
2. Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë për të punuar, mundësinë faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet tjera relevante.
3. Kur alimentacioni kërkohet për fëmiun, gjykata merr parasysh moshën e fëmiut dhe të gjitha nevojat për edukim dhe arsimimin.

Bashkëshorti, siç e cekëm edhe më lart, detyrohet vetëm aq sa ka mundësi. Gjykata vlerëson gjendjen financiare dhe rrethanat tjera të të paditurit

dhe nevojat e paditësit dhe e vendosë vëllimin e mbajtjes financiare dhe alimentacionit të fëmijëve duke u nisur nga këto parime. Gjykata, ndër të tjera, do të duhej të ketë parasysh edhe standardin jetësor në martesë. Fatkeqësisht, gjykatat tona gjatë caktimit të mbajtjes martesore (ushqimisë) dhe alimentacionit, në mënyrë të padrejtë dhe jashta udhëzimeve të dispozitave ligjore, nuk e marrin standardin në martesë si pikënisje, por i referohen standardit të jetesës në Kosovë. Kjo mënyrë e përcaktimit të vëllimit të ushqimisë dhe alimentacionit përpos që është në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka krijuar hapësirë për arbitraritet dhe diskriminim të qytetarëve. Qytetarët mund të kenë standarde të ndryshme jetësore dhe kjo është arsyeja pse në nenin 305, Ligji për Familjen, vëllimin e mbajtjes martesore e ndërlidhë me standardin jetësor në martesë.

Gjykata, për caktimin e lartësisë të vëllimit të alimentacionit për fëmijë duhet ta ketë parasysh edhe nevojën për edukimin arsimimin e fëmiut. Kjo nënkupton se përpos për shpenzimet e ushqimit, veshmbathjes dhe sigurimit shëndetësor, gjykata duhet të llogarisë edhe të gjitha shpenzimet që lindin për shkak të nevojës për edukim dhe arsimim të fëmiut. Fëmiu, varësisht prej moshës mund të ketë kërkesa të ndryshme dhe prandaj edhe shpenzimet dallojnë. Gjithashtu, edhe statusi financiar i të pandehurit mund të ndryshojë. Për këtë arsye, Ligji për Familjen e përcakton në **nenin 331 (Përshtatja e vendimeve për mbajtje)**:

1. Gjykata me kërkesën e paditësve apo personave të detyruar mund të ndryshoj vendimin ashtu që të ndërprej, të shtoj, të zvogëlojë mbajtjen financiare ose alimentacionin i cili është përcaktuar me anë të vendimit të mëparshëm gjyqësor nëse rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar.
2. Kushtet të cilat mund të ndryshojnë janë nevoja personale dhe rritje e shpenzimeve të jetesës në anë të kërkuarit si dhe statusit financiar të të pandehurit në anën tjetër.

# PRAKTIKA GJYQËSORE

## NDARJA E PASURISË MES BASHKËSHORTËVE

Ndarja e pasurisë së përbashkët dhe përcaktimi i kontributit të secilit bashkëshort në krijimin e saj, në rast se bashkëshortët nuk pajtohen për pjesët që duhet t'i takojnë secilit prej tyre, bëhet nga gjykatat. Gjykata, për ndarjen e pasurisë së përbashkët niset nga parimi i barazisë së bashkëshortëve dhe supozimi se bashkëshortët janë pronarë të barabartë të sendeve në pronësi të përbashkët.

Në intervistat me gjyqtarët është theksuar se sipas procedurave ligjore, për prishjen e kurorës nevojiten rreth 1-3 muaj, ndërsa për ndarjen e pasurisë së përbashkët prej tre muaj deri në një vit.<sup>34</sup> Megjithatë, në raste specifike, procedura e ndarjes së pasurisë mund të zgjase për vite të tëra. Problemi qëndron në mosefikasitetin e gjykatave vendore, të cilat janë të ngarkuara me një numër të madh të lëndëve gjyqësore dhe për pasojë e stërgjasin procedurën e ndarjes së pasurisë. Dallim ka edhe mes qyteteve, meqë numri i banorëve të një komune natyrisht e rrit edhe volumin e punës në gjykatën përkatëse.

Sipas gjykatësit Halil Zahiri, “nëse gruaja ka kontribuar, e drejta e kthimit të gjërave të veçanta nga bashkëshorti aplikohet.”<sup>35</sup> Gjykatësit tregojnë se praktika gjyqësore, pasurinë e ndanë duke u bazuar në kontributin e bashkëshortëve sipas konstatimit të ekspertit.<sup>36</sup> Disa gjyqtarë theksojnë se gratë nuk e realizojnë gjysmën e pasurisë së përbashkët për shkak se hezitojnë të kërkojnë të drejtat e tyre të përcaktuara me ligj.<sup>37</sup>

---

34 Intervistë Personale, Halil Zahiri, Gjyqtar, Gjykata Themelore Gjilan.

35 Ibid.


36 Ibid.

37 Intervistë Personale, Nexhat Aliu, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjilan.

## PASURIA E PËRBASHKËT DHE MBAJTJA FINANCIARE

Sipas informatave të gjyqtarëve, procedura për ndarjen e pasurisë zgjatë varësisht nga rastet. Kur lënda apelohehet dhe shkon në Gjykatën e Apelit, atëherë kjo procedurë mund të zgjasë rreth 1-3 vite mesatarisht, sepse ka mungesë të gjyqtarëve. Nëse shkalla e dytë jep vërejtje, rasti kthehet në rigjykim, nëse vërtetohen shkelje ligjore.<sup>38</sup> Procedura nisët prapë prej fillimit. Edhe pse gjyqtarët theksuan se gjykatat i marrin me prioritet këto raste, gjatë intervistave me gratë e divorcuara kemi hasur në raste që zgjasin deri në 10-15 vite. Ndërsa mesatarisht ndarja e pasurisë nga ana e gjykatave zgjatë deri 8 vite.

Daut Çelja, gjyqtar në komunën e Drenasit thekson se “në të gjithë Kosovën është problematike kjo çështja e moskërkimit të së drejtës për ndarje të pasurisë. Gratë, shpesh nuk i kërkojnë të drejtat që u takojnë me ligj sepse hasin në pengesa prej ish-bashkëshortëve. Shumë pak prej grave kosovare kërkojnë ndarjen e pasurisë së përbashkët”.<sup>39</sup> Të njëjtin mendim e ndan edhe avokati Anton Nrecaj, i cili pohoi, “diku 20% e rasteve që na vijjnë në zyrët tona për ndihmë juridike kanë të bëjnë me aspektin e çështjes së pronës ose




<sup>38</sup> Ibid.

<sup>39</sup> Intervistë Personale, Daut Çelja, Gjyqtar, Gjykata Themelore Drenas.

trashëgimisë.<sup>40</sup> Këndvështrimet e shprehura nga gjyqtarët nuk përkojnë me ato të grave të divorcuara, të cilat janë shprehur të pakënaqura me trajtimin që kishin marrë në gjykata. Siç shihet në grafikonin 2 në vazhdim, vetëm 21 përqind të personave të intervistuar vlerësojnë se të drejtat e tyre janë respektuar gjatë vendimmarrjes në gjykatë. Pjesa tjetër nuk janë ndarë të kënaqur me respektimin e të drejtave të tyre.

Ligji në fuqi, përkatësisht *Ligji për Familjen i Kosovës* (LFK), thekson se bashkëshortëve u takon gjysma e pasurisë së krijuar gjatë martesës. Mirëpo, gjatë ndarjes së pasurisë, gratë diskriminohen dhe kontributi i tyre nuk vlerësohet drejtë sipas dispozitave ligjore. Në intervistat e grumbulluara në terren, vihen në pah parregullsitë dhe vështirësitë e grave gjatë procesit të ndarjes së pasurisë. Grafikoni 3 paraqet të përmbledhura pyetje të ndryshme rreth procesit të ndarjes së pasurisë.



Sipas grafikonit, shihet se vetëm 38 % të grave e kanë kërkuar të drejtën e tyre në pasurinë e përbashkët. Prej tyre vetëm një person e ka realizuar atë

40 Intervistë Personale, Anton Nrecaj, Avokat.

të drejtë, por vetëm duke u ndarë me marrëveshje me ish-burrin, pra jo për shkak të ndihmës së gjykatës.

Sa i përket mbrojtjes së të drejtave të tyre, vetëm 55% e grave të intervistuar kanë përshtypjen se janë mbrojtur mirë nga avokatët e tyre, 15% prej tyre konsiderojnë që nuk janë mbrojtur mirë, ndërsa pjesa tjetër prej 30% nuk ishin të gatshme ta bëjnë këtë vlerësim. Gjithashtu, shumë gra të shkukurëzuara ose gjatë procesit të shkukurëzimit, potencuan se nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë gjatë procesit gjyqësor. Ka edhe raste që theksuan se “dëshmia [e saj] është ndërruar gjatë procesit dhe faktet ishin manipuluar.”<sup>41</sup> Dyshimi i saj ishte tek gjyqtarja e rastit e cila sipas gruas së divorcuar, ishte manipuluar ose korruptuar nga ish-bashkëshorti i saj.

Problemi fillestar tek ndarja e pasurisë është kultura patriarkale e shoqërisë kosovare. Gjykatat, ndarjen e pasurisë nuk e bëjnë sipas dispozitave ligjore, por me propozimin e bashkëshortit, i cili pretendon se ka të drejtë në pjesë më të madhe në pronësinë e përbashkët.<sup>42</sup> Ligji për Familjen me nenin 55 e përcakton se vetëm në rast se personi brenda pasurisë së përbashkët e posedon një pasuri të veçantë, atëherë mund ta kërkojë një pjesë më të madhe. Kjo nënkupton se nëse nuk ka pasuri të veçantë, atëherë pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta, siç është e parapare me nenin 47, paragrafi 4 dhe kjo bëhet për shkak se ligji këtë të drejtë e ka legjitimuar përmes punës së grave në shtëpi dhe me fëmijë në nenin 54.

Në disa raste, “disa prindër të papërgjegjshëm punojnë privat, në mënyrë që mos të deklarojnë të ardhurat financiare, për të evituar pagesën e alimentacionit.”<sup>43</sup> Në këto raste, është jashtëzakonisht e vështirë për nënat vetushqyese që të realizojnë të drejtat e tyre, sepse sistemi i drejtësisë dhe gjyqësisë në Kosovë nuk i ka kushtuar fare vëmendjen e nevojshme mashtrimit

<sup>41</sup> Intervistë Personale, B.B., Grua e Divorcuar.

<sup>42</sup> Intervistë Personale, Daut Krasniqi, Avokat.

<sup>43</sup> Intervistë Personale, Blerina Kurtaj, Avokate.

financiar në martesë nga partnerët. Mashtrimi financiar në martesë përmes zvogëlimit të qëllimshëm të rrogës, fshehjes së pasurisë duke e regjistruar në emër të dikujt tjetër, ndërrimi i vendit të punës dhe veprime të tjera të ngjashme, të cilat bëhen me qëllim të përfitimit personal duke i'a shkelur të drejtën në ato të mira materiale bashkëshortit tjetër, janë të dënueshme me Kodin Penal të Kosovës, sipas neneve 251 (Shkelja e detyrimeve familjare), 252 (Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës) dhe 335 (Mashtrimi). Meqë gratë, në të shumtën e rasteve, nuk janë mjaftueshëm të informuara rreth ligjeve dhe të drejtave të tyre, ato rrallë herë janë të vetëdijshme për hapat që duhet të ndër marrin për të pasur sukses gjatë kërkesës së tyre për realizimin e të drejtave të tyre pasurore. Procedurat gjyqësore janë të komplikuar dhe përcillen me ngarkesa emocionale dhe financiare për të gjithë që duhet të përballen me to. Në rastet e grave të divorcuara, një pjesë e të cilave kanë kaluar edhe nëpër faza të dhunës në familje, këto procedura janë jashtëzakonisht të rënda për shkak të gjendjes së traumatizuar shpirtërore në njërin anë, por edhe vështirësive të tyre të shumëllojshme në anën tjetër. Këto nëna zakonisht kanë edhe fëmijët me vete për të cilët duhet të përkujdesen. Në shumë raste fëmijët janë të moshës së mitur, gjë që ua pamundëson nënave të hyjnë në marrëdhënie pune për të garantuar mbijetesën për fëmijët dhe veten. Ato përballen me dhimbjen dhe traumën shpirtërore nga pasojat shumëvjeçare të dhunës psikike, ekonomike dhe fizike, me sfidat për mbijetesë, me frikën se për arsye të kushteve të vështira ekonomike gjykata mund të vendosë që fëmijët t'i besohen babait, me ngarkesën si ta paguajnë një avokat dhe si të gjejnë kohën për t'u konsultuar me avokatin apo edhe thjesht ku t'i lënë fëmijët gjatë kohës kur duhet të mirren me seancat gjyqësore apo takimet me qendrat për punë sociale.

Një numër i grave përpos këtyre vështirësive, në raste të divorcit, nuk gjejnë mbështetje as nga familjet e tyre, sepse mendësia e përgjithshme në Kosovë pret nga gratë që ato të pajtohen me "fatin e jetës" dhe të nënshtrohen nën çfarëdo regjimi të burrit, qoftë ai edhe i dhunshëm. Shoqëria kosovare edhe

sot e tutje e përdorë shprehjen “nusja ishte shumë e mirë, zëri nuk i dëgjohej!”. Kjo len shumë për të kuptuar kur rikujtojmë se fjala është për dhunë në familje, e cila shpeshherë ndodhë vetëm për arsye të shprehjes së pakënaqësisë me mënyrën e trajtimit që gratë marrin nga burrat. Në Kosovë ende mendohet se gratë duhet “të ulin kokën” dhe të pajtohen me çfarëdo që bën apo thotë burri. Sepse ai është “burrë dhe i ka hije”, ndërsa gruaja “duhet ta dijë vendin dhe rolin e saj!”.

Një mendësi e tillë fatkeqësisht ende mbizotëron në shoqërinë tonë. Të rralla janë rastet kur çiftet e shohin njëri-tjetrin si të barabartë. Edhe më të rralla janë rastet, kur çifti mendon se pasuria e krijuar gjatë martesës duhet të ju takojë të dy bashkëshorteve në pjesë të barabarta dhe se rritja e fëmijëve, edukimi i tyre dhe mirëmbajtja e shtëpisë vlerësohen të mjaftueshme për t’ia ndarë gjysmën e pasurisë gruas, e cila ka qenë amvise, edhe pse kjo është e rregulluar me ligj. Përballja me sistemin diskriminues, jo-profesional dhe patriarkal është mjaft sfiduese për secilin. Shtuar kësaj edhe mundësitë më të mëdha ekonomike për korrupsion dhe ndikim në gjyqësor nga ana e burrave, situata e grave gjatë betejës për të drejtat e tyre të garantuara me ligj është dëshpëruese deri në atë masë, sa ato shpeshherë detyrohen të dorëzohen. Një e intervistuar tregon se si është pajtuar me një pjesë tepër më të vogël se që i takon në realitet, vetëm për shkak të presionit të sistemit. Ajo ka theksuar se “nga 240.000 euro të pasurisë, nëse do ndahej në gjysmë, do të më takonin 120.000 euro. Unë kam marr vetëm 25.000 euro dhe i kam pranuar, jo nga padituria, por si pasojë e dyshimit se në gjykatë mundet me pas manipulime dhe korrupsion.” Gjykata për dy fëmijët e kësaj zonje kishte caktuar shumë prej 200 euro alimentacion dhe asgjë për ushqiminë për nënën, megjithëse ish-bashkëshorti kishte një rrogë mbi 3000 euro. Vëllimi kaq i ulët për alimentacion dhe mohimi i të drejtës për ushqiminë për personin në fjalë janë shkelje drastike të të drejtave të fëmijëve, të të drejtave të njeriut, të së drejtës për një trajtim të barabartë para ligjit, të ligjit kundër diskriminimit, të së drejtës për mbajtje financiare sipas neneve 285, 298, 299 dhe 305. Sipas



së intervistuarës, ish-bashkëshortit “deri në 2013 nuk ka pagu alimentacion (2 vite) si dhe nuk është shqiptuar masa në mënyrë retroaktive”.

Diskriminimi ndaj grave që ndodhë në gjykata paraqet një shkelje të rëndë të drejtave të njeriut dhe sidomos të grave. Mendësia patriarkale, e bazuar në parimin se burri është kreu i shtëpisë dhe gruaja duhet të jetë e kënaqur nëse ushqehet dhe banon në shtëpinë e përbashkët, mbizotëron edhe brenda përbrenda personelit nëpër gjykata. Gjatë hulumtimit ka pasur pikërisht argumente të llojit të tillë, pas pyetjes se si vlerësohet kontributi i gruas në shtëpi dhe çfarë shume do t'i ndahej gruas në emër të pasurisë martesore, nëse ajo nuk ka qenë e punësuar jashtë shtëpisë, por i ka rritur fëmijët dhe është përkujdesur për mirëmbajtjen e shtëpisë. Përgjigja ka qenë se nuk do t'i ndahej asgjë, sepse ajo ka ngrënë dhe ka banuar në atë shtëpi. Kjo len të nënkuptohet se gruaja edhe nga gjyqtarët trajtohet jo më mirë se një skllave, e cila për punët që bën mund të marrë një copë bukë dhe të flejë nën çatinë e njejtë, por që nuk i takon asgjë më shumë nga të mirat e krijuara gjatë martesës. E gjithë kjo është në kundërshtim diametral me ligjin në fuqi, i cili pasurinë e krijuar gjatë martesës e ndan parimisht në pjesë të barabarta, pa marrë parasysh cili nga bashkëshortët sa ka punuar jashtë shtëpisë.

Për shkak të kësaj mendësie edhe në radhët e gjyqësorit, gjatë procedurave gjyqësore gratë diskriminohen mbi baza gjinore. Diskriminimi i grave ndodhë sepse është krijuar një praktikë gjyqësore, e cila gratë i diskriminon mbi baza gjinore, duke mos e vlerësuar fare si të barabartë kontributin e tyre si nënë dhe amvise në shtëpi, përkundër që Ligji për Familjen e ka saktësuar këtë.

Angazhimi me punët e shtëpisë, pra amvisëria, ende nuk vlerësohet si punë në Kosovë, edhe pse në shtetet tjera evropiane kjo temë është mbyllur qëmoti dhe e drejta e grave në gjysmën e pasurisë së krijuar gjatë martesës është parim i padiskutueshëm i drejtësisë.

Shumica e grave kosovare janë të papuna. Numri i grave të punësuar

është vetëm 12.7 %. Sipas avokatit Anton Ndrecaj, “puna e gruas njësoj llogaritet sikurse burri që ka punuar dhe ka marrë pagë ose ka pasë biznes, sepse njëri ka kontribuar në të ardhura financiare dhe tjetri ka kontribuar në familje.”<sup>44</sup> Mirëpo, nga gjykatat, puna brenda shtëpisë nuk është konsideruar e barasvlefshme me një punë të paguar me rrogë.

Bazuar në raporte te ndryshme, gjatë rasteve të divorceve është vërejtur tendenca nga ana e gjykatave për të minimizuar vlerën e punës së grave në shtëpi.<sup>45</sup> Praktika kosovare gjyqësore, në kundërshtim me ligjin, e ka instaluar një interpretim diskriminues të Ligjit për Familjen kur bëhet fjalë për ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare. Ngaqë, të ndikuar nga botëkuptimi i tyre patriarkal, nuk kanë qenë në gjendje ta pranojnë se sipas ligjit pasuria e përbashkët e krijuar gjatë martesës ndahet në pjesë të barabarta, kanë filluar të gjejnë mënyra të tjera se si ta vlerësojnë shumën, e cila do të duhej t'i ndahej bashkëshortit/es të papunë. Për këtë, nga gjykatat është angazhuar një ekspert financiar, i cili me profesion zakonisht është ekonomist. Angazhimi i një eksperti financiar për të vlerësuar çfarë pjese të pasurisë duhet gjykata t'ia ndajë bashkëshortëve nuk është e përcaktuar në asnjë dispozitë ligjore. Nuk ekziston asnjë udhëzim administrativ apo dokument tjetër institucional, i cili do ta legjitimonte angazhimin e një eksperti financiar për të vlerësuar çfarë shume duhet t'i ndahet bashkëshortëve. Përmes dorëzimit të kësaj pjese të ndarjes së drejtësisë, gjykatat kosovare i kanë ikur përgjegjësisë së tyre për të ndarë pasurinë e përbashkët në rast të mosmarrëveshjes mes bashkëshortëve rreth pjesëve që duhet të ju takojnë gjithsecilit. Neni 54 i Ligjit për Familjen e saktëson se në rast të mosmarrëveshjes, kompetente është gjykata. Dhe ajo duhet t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat, përfshirë kontributin në shtëpi, e jo vetëm të ardhurat (neni 54).

Nuk ekziston asnjë rast i njohur deri më tani, ku gjykata do ta kishte ndarë

---

<sup>44</sup> Intervistë Personale, Anton Ndrecaj, Avokat.

<sup>45</sup> Drenusha Morina, “Kur vjen puna te ndarja - Amvisëria nuk njihet si punë.” Periskopi, 2018, marrë nga, <https://www.periskopi.com/kur-vjen-puna-te-ndarja-amviseria-nuk-paguhet-e-spo-njihet-si-pune/>

pasurinë e përbashkët në pjesë të barabarta, nëse njëri prej bashkëshortëve nuk është pajtuar me ndarje të barabartë. Shumica e burrave nuk do të pajtoheshin me ndarjen e barabartë të pasurisë, sepse mendojnë se vetëm kontributi financiar apo material duhet të vlerësohet si pasuri. Gjykatat e Kosovës, në këtë rast do të duhej t'i referoheshin nenit 55, i cili thotë se njëri prej bashkëshortëve mund të kërkojë një pjesë më të madhe nga pasuria martesore **vetëm** nëse ka investuar me pasuri të veçantë. Kjo nënkupton se nëse nuk ekziston dëshmia e një pasurie të veçantë, të krijuar para martesës në emër të atij bashkëshorti, apo dëshmia e një dhurate apo trashëgimie, atëherë asnjëri nga bashkëshortët nuk ka të drejtë të kërkojë një pjesë më të madhe se sa tjetri.

Në procedurat gjyqësore për ndarjen e pasurisë, nga gratë kërkohet që ato të dëshmojnë sa kanë kontribuar materialisht. Kjo është e jashtëligjshme, sepse nuk është e përcaktuar në asnjë dispozitë ligjore. Nëse një nënë gjatë kohës së shtatzanisë, rritjes dhe edukimit të fëmijëve, mirëmbajtjes së shtëpisë dhe përkrahjes së burrit nuk ka punuar me rrogë, ajo natyrisht se nuk është në gjendje të kontribuojë materialisht. Për këtë arsye neni 54 e udhëzon gjykatën që gjatë ndarjes së pasurisë të ketë parasysh edhe “kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët” (neni 54). Gjithashtu, ligji thekson në nenin 47 se bashkëshortët “janë pronarë të barabartë në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët”.

Gjatë hulumtimit është zbuluar mënyra diskriminuese e vlerësimit të kontributit, siç ai aplikohet në gjykatat e Kosovës. Nëse një nënë nuk ka qenë

e punësuar gjatë kohëzgjatjes së martesës dhe ka kërkuar ndarjen e pasurisë së përbashkët, gjykata e ka caktuar një ekspert për ta bërë vlerësimin se çfarë shume duhet t'i takojë asaj. Puna e grave në shtëpi nga ekspertët është e vlerësuar me rrogën minimale 130 Euro. Sipas kësaj, del në pah se grave për vitet që kanë jetuar me bashkëshortin, nuk i është ndarë pasuria e përbashkët sipas ligjit, sepse puna e amvisërisë nuk është konsideruar të ketë kontribuar në shtimin e pasurisë, edhe pse kjo punë pikërisht nga ligji në nenin 54 konsiderohet si kontribut për shtimin e pasurisë. Ndryshe, si do të mund të ishte duke punuar bashkëshorti, nëse gjatë asaj kohe nuk do të kujdeses nëna për fëmijët? Bashkëshorti/ja i/e punësuar e ka gëzuar privilegjin që të punojë pa shqetësime, mu për faktin se për fëmijët dhe shtëpinë është kujdesur bashkëshortja/i.

Përpos kësaj, gjatë ndarjes së pasurisë sipas logjikës së përdorur nga gjykatat, ku punës së gruas i caktohet shuma prej 130-150 Euro në muaj, bëhet shkelje e rëndë, meqë këtu nuk po ndahet pasuria e përbashkët, por po paguhet një rrogë në formë retroaktive për vitet sa gruaja ka qëndruar në shtëpi dhe ka punuar si amvise. Kjo nënkupton se nuk mirret parasysh sa ka qenë vëllimi i pasurisë së krijuar gjatë martesës dhe ajo pasuri të ndahet 50/50 siç e parasheh ligji, por punës së gruas në shtëpi i caktohet një vlerë materiale dhe shumëzohet me muajt dhe vitet sa ajo ka jetuar në bashkësinë martesore. Kjo praktikë gjyqësore përpos që e diskriminon skajshmërisht gruan dhe e dëmton atë materialisht dhe emocionalisht duke ia shkelur të drejtat e saj, në këtë formë edhe përbën shkelje të ligjit, i cili në dispozitat ligjore përkitazi me ndarjen e pasurisë së përbashkët e ka të përcaktuar se në rast se nuk ekziston pasuri e veçantë (e krijuar para martesës, e marrë si dhuratë apo si trashëgimi), atëherë vlen parimi i ndarjes së pasurisë në pjesë të barabarta. Kjo është shkelje e rëndë ndaj grave dhe ndaj ligjit dhe si e tillë një praktikë e papranueshme dhe e dëmshme për shoqërinë. Çuditërisht, për burrat ka funksionuar ligji me parimin 50/50 të ndarjes së pasurisë, siç është rasti i znj. N-G. nga Prishtina. Ish-bashkëshortit të saj, përkundër faktit se ai

nuk ka kontribuar fare në blerjen e banesës, gjykata pa kërkuar asnjë dëshmi materiale i'a ka ndarë gjysmën e pasurisë, duke argumentuar se kjo ndarje bëhet sipas parimit 50/50 të ndarjes së pasurisë së përbashkët. Ky vendim është marrë në vitin 2013 në gjykatën themelore të Prishtinës dhe është rasti i vetëm kur gjykata e ka ndarë pasurinë e përbashkët në pjesë të barabarta, pa kërkuar dëshmi materiale. Mirëpo, ky rast ka qenë kur ajo e drejtë është ndarë në favor të burrit. Asnjë grua nuk e ka fituar deri më sot gjysmën e pasurisë së përbashkët në këtë mënyrë.

## Mirëmbajtja Financiare mes Bashkëshortëve

Ligji për Familjen i Kosovës e rregullon edhe të drejtën e mbajtjes financiare, respektivisht alimentacionin (për fëmijët) dhe ushqiminë (për bashkëshorten/in e papunë). Me këtë institut juridik rregullohet e drejta e personave, të cilët nuk kanë mjete të domosdoshme për ekzistencë, për mbajtje financiare nga personat që sipas ligjit janë të detyruar të japin mbajtjen. Ligji për Familjen i Kosovës përkufizon mbajtjen financiare si detyrim financiar dhe material. Sipas nenit 298 “bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij financiare.” Në bazë të këtij neni, nuk është fare e nevojshme që bashkëshorti të jetë duke u kujdesur për fëmijë apo të ketë fëmijë. Vetëm fakti që është e/i papunë mjafton që të t'i takojë e drejta e mbajtjes financiare (ushqimisë). Neni pasues 299 tutje përcakton se “Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punojë.” Kjo nënkupton se përpos alimentacionit, i cili duhet të ofrohet për mirëqenien e fëmijut, personave që përkujdesen për fëmijun ju takon të marrin edhe mbajtjen financiare për mirëqenien e tyre nga

ish-bashkëshorti/ja. Mirëpo në gjykatat tona, 78.6% e grave të divorcuara nuk kanë mundur ta fitojnë të drejtën e tyre për ushqimi. Praktika gjyqësore nuk i zbaton të drejtat ligjore të grave.

Moszbatimi i ligjeve në fuqi dhe diskriminimi institucional i grave si pasojë e patriarkalizmit mbizotërues në mesin e gjyqtarëve ka krijuar sfida serioze tek gratë. Sikurse te proceset e ndarjes së pasurisë së përbashkët, ku grave ju mohohet ndarja e barabartë e pasurisë, poashtu edhe te caktimi i vëllimit të alimentacionit për fëmijë janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore.

Parimi bazë gjatë divorceve dhe ndarjes së pasurisë duhet të jetë kujdesi ndaj mirëqenies së fëmijut. Neni 285 (Shtrirja e mbajtjes) përcakton se “shtrirja e mbajtjes duhet të jetë adekuate me kushtet nën të cilat ka jetuar personi që ka të drejtë në mbajtje. Në rast se personi ka jetuar në kushte të rënda, mbajtja duhet të sigurojë së paku minimumin që nevojitet për të mbajtur një jetë të rëndomtë dinjitoze. (2) Mbajtja përfshin të gjitha kërkesat e domosdoshme për jetë, duke përfshirë të gjitha shpenzimet e domosdoshme për trajnim dhe shkollim për të fituar profesion.” Sipas këtij neni, alimentacioni që duhet të ndahet për fëmijun duhet të ketë parasysh kushtet në të cilat ka jetuar fëmiju para ndarjes së prindërve. Fatkeqësisht, praktika gjyqësore në gjykatat e Kosovës, caktimin e shumës së alimentacionit e bëjnë në formë arbitrare, duke e marrë për bazë standardin minimal në Kosovë. Kësisoj, ndodhë që për fëmijët ndahet alimentacion prej 50 Euro deri maksimalisht 200 euro. Shtuar kësaj edhe mashtrimet e mëdha ekonomike që bëhen nga burrat gjatë rasteve të divorceve dhe ndarjes së pasurisë, si dhe mosndjekjen dhe refuzimin për t'i hetuar këto raste, për gratë përballja me drejtësinë është një luftë thuajse e humbur. Për ta ilustruar vetëm duhet pasur parasysh se një numër i madh i burrave në raste të inicimit të procedurave gjyqësore e ndryshojnë kontratën e punës, duke dëshmuar rrejtshëm para gjykatës një rrogë më të ulët se që e kanë pasur apo edhe e realizojnë. Normalisht, gjykatat do të duhej të kërkonin dëshminë për transferin bankar të asaj rroge të falsifikuar edhe përgjatë periudhës sa çifti nuk kanë qenë nëpër procedura gjyqësore. Mirëpo në Kosovë, gjykatat me raste

e marrin për bazë edhe një rrogë e cila është ndryshuar gjatë procedurave gjyqësore, duke mos zhvilluar hetime për atë rrogë. Kësisoj baza, mbi të cilën mirret vendimi se sa të jetë alimentacioni për fëmijët është e ulët dhe gjykata ua ndan fëmijëve një shumë, më të cilën është e pamundur të mbijetohet.

Përpos që ndryshimi i rrogës gjatë procedurave gjyqësore nuk hetohet nga gjykatat, por përkundrazi mirret si bazë për një vendim të padrejtë në lidhje me shumën e alimentacionit, gjykata poashtu nuk e respekton nenin 330 [Parimet e përcaktimit të mbajtjes dhe alimentacionit], i cili thotë se detyrimi për alimentacion “përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit”, që nënkupton se përpos rrogës duhet të mirren parasysht edhe asetet tjera në posedim të personit, siç është prona apo ndonjë pasuri tjetër materiale në formë të llogarive të ndryshme bankare.

Hulumtimi kësisoji ka dëshmuar se praktikat gjyqësore i diskriminojnë gratë edhe gjatë ndarjes së alimentacionit.<sup>46</sup> Kjo e drejtë është e garantuar me ligj dhe si e tillë paraqitet si detyrim ligjor për palën, e cila sipas ligji është e detyruar ta ofrojë atë. Por, për ta bërë gjendjen edhe më të rëndë, as ato alimentacione të caktuara me vendim të gjykatës shpeshherë nuk ofrohen. Në raste kur nuk paguhet alimentacioni, nënat janë të detyruara të inicojnë procedura penale, sepse gjykatat nuk kujdesen mjaftueshëm për përmbarimin dhe detyrimin e personit për përmbushjen e kërkesës ligjore për alimentacion.

Sipas intervistave të realizuara me gratë e divorcuara, përkundër faktit se 70% kanë vendim të gjykatës për alimentacione, vetëm 25% e grave deklaruan se marrin alimentacion me rregull. Një e intervistuar tregon se përkundër faktit se ish-burri e kishte rrogën mbi 4000 Euro në muaj, gjykata asaj ia kishte caktuar një alimentacion vetëm 250 Euro për fëmijun. Shqetësues është fakti se e njëjta thekson se vetëm për shkak të frikës nga familja e saj, ish-burri

---


<sup>46</sup> Arita Gërxfhalii, “Viktimsë së dhunës nuk i paguhet ushqimi i fëmijës nga ish bashkëshorti,” Kallxo.com, 2017, marrë nga, <https://kallxo.com/viktimes-se-dhunes-nuk-paguhet-ushqimi-femijes-nga-ish-bashkeshorti/>

e paguan alimentacionin, që nënkupton se gjykatat nuk po e përmbushin detyrën e tyre sipas mandatit, por që qytetarët po duhet të mbështeten në forcat e tyre dhe të kthehen sërish te forma të tjera të ndarjes së drejtësisë. Ngjashëm si në rastin e saj, edhe një tjetër e intervistuar tregon se merr vetëm 200 Euro alimentacion, megjithëse burri e ka rrogën mbi 2000 Euro.

Kur janë pyetur për praktikën gjyqësore, përkatësisht se a ka qenë korrekt ndarja e pasurisë, vetëm 5% e grave të divorcuara kanë deklaruar po, mirëpo në këtë rast çiftet e kanë ndarë pasurinë me marrëveshje në bazë të vullnënit të mire të bashkëshortëve dhe jo si rezultat i praktikave gjyqësore.<sup>47</sup> Edhe pse 60% janë përgjigjur se ish-bashkëshorti nuk ka pasur pasuri të veçantë para martesës, prapë se prapë këto gra nuk kanë mundur ta realizojnë të drejtën e tyre për gjysmën e pasurisë së përbashkët, përkundër faktit se atyre sipas ligjit do të ju kishte takuar.

Në pyetjen si e vlerësojnë trajtimin nga ana e gjykatës, të intervistuarat janë përgjigjur me 74 % se ka pasur shkelje të korrektësisë. Vetëm 16 % për tyre vlerësojnë se janë trajtuar korrekt, ndërsa 10 % nuk kanë dhënë përgjigje. Një nga të intervistuarat thekson “unë gjithmonë kam fol me fakte, dokumente, gjykatësja nuk është bazuar në dokumente, por në fjalë të kota” [të ish-bashkëshortit].

Gjatë procedurave gjyqësore, a keni pasur ndjenjën se po trajtoheni me korrektësi nga ana e gjykatës/gjyqtarëve?




<sup>47</sup> Intervistë Personale, M.L., Grua e divorcuar.



Në pyetjen se janë marrë parasysh të drejtat e tyre gjatë vendimmarrjes së gjykatës, nga numri i atyre që janë përgjigjur, 40 % mendojnë se të drejtat e tyre janë marrë parasysh deri diku, ndërsa 33 % mendojnë se nuk janë marrë parasysh fare. Në përgjithësi, vetëm 27 % ishin të mendimit se të drejtat e tyre janë respektuar gjatë vendimmarrjes së gjykatës. Rrjedhimisht, 74% e të intervistuarave kanë shprehur se gjatë procedurave gjyqësore ka pasur shkelje të korrektësisë nga ana e gjyqtarëve.


Gjatë procedurave gjyqësore, sa mendoni se janë respektuar të drejtat e juaja në vendimmarrjen e gjykatës?



Prej të intervistave është zbuluar se në 70% të rasteve gratë kanë pësuar prej mashtrimit ekonomik. Llojet e mashtrimit të evidentuara janë prej tjetërsimit të pronës, deri te mosdeklarimi i drejtë dhe fshehja e pasurisë. Në shumicën e rasteve, edhe pse gjykata ka marrë vendimin për alimentacion, ish-bashkëshortët nuk e paguajnë alimentacionin. Njëra nga të intervisturat tregon se “ish-bashkëshorti një pjesë të pasurisë e ka vendosë në emër të vëllaut, tjetrën në emër të një shokut, e kjo është si rezultat i stërzgjatjes së procedurave në gjykatë me ç’rast burrat i bartin pronat në emër të dikujt tjetër.” Përkundër ankesave të grave në gjykata për mospërmbushje të detyrimit ligjor për alimentacion, vetëm 25% prej tyre kanë arritur ta sigurojnë alimentacionin. Vëllimi i alimentacionit në shumicën e rasteve është tejet i ulët dhe në asnjë rast nuk i është përmbajtur nenit 285, i cili kërkon që mbajtja financiare të bëhet konform kushteve paraprake.

## PASURIA E PËRBASHKËT DHE MBAJTJA FINANCIARE


Sfidë tjetër mbetet mungesa e informimit. Në pyetjen se sa mendojnë gratë se i njohin të drejtat e tyre, as gjysma e tyre nuk mendonin se i njohin mirë ato të drejta. Duke marrë parasysh se në pyetjet rreth njohurive të tyre, njerëzit zakonisht nuk kanë dëshirë të dalin të padijshëm, përgjigjet e pranuar na lënë të kuptojmë se gratë kosovare nuk janë mjaftueshëm të informuara rreth të drejtave të tyre. Por edhe ato që janë të informuara dhe i kërkojnë të drejtat e tyre, në shumicën e rasteve hasin në sfida të mëdha për t'i realizuar ato të drejta, sepse sistemi gjyqësor në Kosovë gjatë vendimmarrjes në procedura gjyqësore në masë të madhe ndikohet nga mendësia e përgjithshme patriarkale, e cila më shumë bazohet në norma shoqërore tradicionale dhe diskriminuese ndaj grave, se sa në shkronjën dhe frymën e ligjit.



Sikurse tek ndarja e pasurisë, edhe në fazën e mirëmbajtjes financiare, gratë e divorcuara kanë treguar shumë parregullsi dhe vështirësi në respektimin e të drejtave të tyre konform ligjeve në fuqi. Njëra nga të intervistuarat thekson se është “caktuar shuma 200 euro, dhe pastaj e kanë zbritë në 150 Euro prej gjykatës së apelit, mirëpo për tri vite që ka zgjatë procedura gjyqësore në

gjykatë derisa është ardhë seanca ju ka mbledhë një shumë diku prej 5-6 mijë Euro (të cilat nuk i ka paguar ende).

Njëra nga gratë e intervistuar deklaroi se ish-bashkëshorti asnjëherë nuk paguan me rregull alimentacionin. “Para se djali t’i mbushte 18 vjeç, ish-burri ka thënë që po i mbledh paratë për shkollim si arsye e mospagesës së alimentacionit, por edhe pasi djali ka filluar studimet, ai nuk i ka paguar asnjëherë paratë. Edhe pse unë ankoem vazhdimisht, ai fillon të paguajë dhe pas një kohe prapë i ndalë. Gjykata nuk ka mundur t’ia konfiskojë pasurinë, sepse ai nuk ka të regjistruar asnjë aset (shtëpi, veturë) në emër të tij.”<sup>48</sup> Në raste të tilla vërehen implikimet ligjore ku organet e rendit nuk arrijnë t’i qasen problemit në mënyrë efektive dhe kjo pastaj manifestohet në përkeqësimin e kushteve të jetesës për gratë e divorcuara dhe fëmijët e tyre. Më poshtë, (Tabela 5) janë të akumuluar disa pyetje të hapura rreth alimentacionit nga intervistat përkatëse:



48 Intervistë Personale, Sh.A., Grua e Divorcuar.

## PASURIA E PËRBASHKËT DHE MBAJTJA FINANCIARE

Sipas intervistave me gratë e divorcuar dhe krahasimit të kornizës ligjore me praktikën gjyqësore të aplikuar në rastet e intervistuar, vërehet një diskrepancë e thellë mes kornizës ligjore dhe praktikave gjyqësore. Në të gjitha dispozitat ligjore në lidhje me pasurinë e përbashkët dhe mbajtjen financiare (alimentacioni dhe ushqimia) është identifikuar një zbatim i mangët ose nuk ka pasur fare zbatim të tyre.

# PËRFUNDIM

Kosova ka përpara sfida të mëdha si në aspektin politik, poashtu edhe në atë ekonomik dhe shoqëror. Gjithsesi, sfida dhe detyra më e rëndësishme është garantimi i një kornizë të drejtë dhe efektive ligjore dhe mbi të gjitha implementimi i drejtë i dispozitave. Vetëm një shoqëri e bazuar në ligje të drejta mund të zhvillohet në një demokraci prosperuese.

Përkundër kornizës ligjore të avancuar, shoqëria kosovare mbetet shoqëri patriarkale dhe vazhdon t'i rezistojë ndryshimit. Shoqëria kosovare ende nuk ka arritur ta kuptojë ndërlidhjen e drejtpërdrejtë mes të drejtave të barabarta për gratë dhe zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Marrëdhëniet shoqërore mes gjinive ende funksionojnë bazuar në paradigma të një kohe të shkuar, kur burri ka qenë “kreu” i shtëpisë. Prandaj edhe diskriminimi dhe dhuna ndaj grave mbeten një problematikë e theksuar në Kosovë. Gratë vazhdojnë të mbeten të diskriminuara në të gjitha frontet. Ato nuk gëzojnë pasurinë që u takon, nuk kanë poste të rëndësishme, nuk janë mjaftueshëm të përfshira në punësim. Mbi të gjitha, sipas hulumtimeve tona dhe intervistave po vërtetohet ajo, për çfarë gratë janë ankuar ka një kohë të gjatë, që është diskriminimi i skajshëm gjinor para ligjit dhe brenda institucioneve.

Ky hulumtim është ndërmarrë pas ngritjes së çështjes së diskriminimit të grave gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare në procedurat e divorcit dhe ndarjes së pasurisë. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Familjen, ishte bërë puna fillestare dhe e domosdoshme për të qartësuar dhe saktësuar mangësitë ligjore të Ligjit për Familjen. Hapi i parë që të sigurohej një qasje e drejtë në pasurinë e përbashkët, pa mundësi keqinterpretimi, kishte rezultuar i suksesshëm. Mirëpo, në sistemin gjyqësor të Kosovës, problemi kryesor qëndron në zbatimin e drejtë të ligjeve, pra në praktikën gjyqësorë. Rrjedhimisht, për të ndryshuar praktikën gjyqësore duhej fillimisht të sqarohet korniza ligjore, për

të dëshmuar pastaj përmes rasteve konkrete qasjen e gabuar të praktikës gjyqësore. E gjithë kjo është ndërmarrë me qëllimin që të ndryshohet praktika gjyqësore për çështjen në fjalë, pra për ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare.

Hulumtimi ka gjetur shkelje të dispozitave ligjore rreth ndarjes së pasurisë së përbashkët, ku vështirësia në interpretim kishte qenë në caktimin e vlerës që i bëhej kontributit të bashkëshortit/es të papunë, që kujdesej për rritjen e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e shtëpisë. Ky kontribut, ndonëse sipas Ligjit për Familjen kishte vlerën e barabartë si të ardhurat e bashkëshortit/es tjetër, në praktikën gjyqësore pësonte një degradim në një vlerë të një rroge minimale. Gjithashtu është konstatuar se neni 55, i cili e saktëson se në cilin rast një person ka të drejtë të kërkojë një pjesë më të madhe se gjysmën e pasurisë, nuk zbatohet drejtë. Sipas këtij neni 55 do të duhej që vetëm personi, i cili e pretendon një pjesë më të madhe të dëshmojë se ka poseduar një pasuri të veçantë. Nëse nuk dëshmohet një gjë e tillë, gjykata nuk ka të drejtë dhe asnjë dispozitë nuk këshillon që të kërkohen dëshmi materiale, siç praktikohet në gjykatat tona, ku nga gratë kërkohet të dëshmojnë përmes faturave dhe transfereve se ato kanë kontribuar në shtimin e pasurisë. Kjo ka qenë një shkelje e dispozitave ligjore.

Tutje, në gjykatë është angazhuar një ekspert financiar, i cili është dashur të vlerësojë shumën që do t'i takonte njërit bashkëshort në bazë të kontributit në shtëpi. As për këtë praktikë gjyqësore nuk ka bazë ligjore, sepse asnjë dispozitë nuk e rregullon kështu. Eksperti financiar mund të merret vetëm për të caktuar vlerën e sendeve, e jo të kontributit me rritje e edukim të fëmijëve dhe mirëmbajtje të shtëpisë, sepse vlera e tyre është përcaktuar me ligj se është sa gjysma e pasurisë. Neni 47 (në versionin e vjetër dhe atë aktual) e ka pasur të theksuar se “bashkëshortët janë pronarë të barabartë në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët”.

Dispozitat për mbajtjen financiare, si ato për allimentacion poashtu edhe ato

për ushqiminë janë interpretuar dhe zbatuar gabimisht. Së pari, vëllimi apo shtrirja në të dyja rastet është bërë në kundërshtim me dispozitat përkatëse, nenet 285 dhe 305. Të dyja këto nene udhëzojnë se vëllimi i mbajtjes financiare duhet të bëhet sipas kushteve që personi ka pasur më herët dhe sipas standardit jetësor në martesë. Fatkeqësisht, në shumë aktvendime në lidhje me këto dispozita, arsyetimi për vëllimin e ulët, si të alimentacionit poashtu edhe të ushqimisë, ndërlidhet me standardin jetësor në Kosovë. Kjo nënkupton se gjyqtarët e marrin për bazë standardin jetësor në Kosovë për të caktuar alimentacionin dhe ushqiminë, gjë që është në kundërshtim me ligjin, dhe si e tillë përbën shkelje të ligjit. Mbi të gjitha, kjo shkelje e dispozitave ligjore i dëmton rëndë fëmijët dhe nënat kosovare, duke u'a mohuar qasjen e drejtë në të drejtat e tyre dhe duke u'a vështirësuar sigurimin e bazës për ekzistencë.

Hulumtimi ka gjetur së 78% të grave nuk marrin ushqimi, edhe pse ushqimia ju takon sipas ligjit. Të drejtën për alimentacion për fëmijë gjykata ua ka ndarë vetëm 70% të grave. Por nga këto, vetëm 25% të tyre e marrin alimentacionin me të vërtetë. Arsyeja për këtë është neglizhenca e gjykatave që të përmbarojnë shumën e alimentacionit apo ta detyrojnë personin përgjegjës që ta realizojë pagesën e alimentacionit.

Është gjetur se asnjë grua deri më tani nuk e ka fituar të drejtën e saj ligjore për gjysmën e pasurisë së përbashkët. Disa nga gratë kanë theksuar se janë pajtuar me një shumë tepër më të vogël sesa ajo që realisht ju takon sipas ligjit, duke ditur se gjykatat kosovare i diskriminojnë gratë dhe se është një gjë e lehtë për palën tjetër që të ndikojë në gjyqësor në favor të vetin.

Një fenomen tjetër i përhapur ka rezultuar të jenë mashtrimet ekonomike gjatë procedurave të ndarjes së pasurisë dhe mbajtjes financiare. Mashtrimet që rëndom bëhen nga pala tjetër rezultuan të jenë bartja e pasurisë në emër tjetër, fshehja e pasurisë, ndërrimi i rrogave e mashtrime të tjera, të cilat janë vepra penale sipas Kodit Penal. Fatkeqësisht, në Kosovë këtyre veprave

penale të mashtrimit financiar në martesë nuk i është kushtuar vëmendja e nevojshme. Kjo është një fushë ku gjyqësia kosovare duhet të fillojë të punojë me seriozitetin e kërkuar sikurse tek veprat penale në raste tjera. Ligji nuk e amnistionon veprën penale të kryer gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Poashtu është vërejtur se ka dallime mes pohimeve të gjyqtarëve dhe grave të intervistuarra për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore. Gratë janë ankuar për procedura të stërzgjatura dhe për trajtim jo-korrekt. Shumica e grave janë shprehur se të drejtat e tyre nuk janë respektuar gjatë vendimmarrjes së gjykatës.

Rezultatet e këtij hulumtimi kanë dëshmuar se në cilat çështje dhe si diskriminohen gratë nëpër procedurat gjyqësore rreth ndarjes së pasurisë dhe mbajtjes financiare. Vështirësia kryesore me të cilën përballen gratë gjatë përpjekjes për realizimin e të drejtave të tyre është se sfidën më të rëndë e përbëjnë shkeljet e të drejtave të tyre nga vetë sistemi gjyqësor. Këto shkelje ndodhin për arsye të ndryshme, një ndër to edhe mendësia patriarkale brenda vetëm personelit gjyqësor. Është vërejtur se ekziston një njohje e pamjaftueshme e dispozitave ligjore nga gjyqtarët, por edhe një mungesë e përkushtimit profesional ndaj rasteve. Këtë e dëshmon më së miri ndarja jo e drejtë e pasurisë së përbashkët. Por në mënyrën më të qartë, kjo tendencë e vendimmarrjes arbitrare shihet gjatë caktimit të vëllimit të alimentacionit dhe ushqimisë në rastet kur shuma e caktuar e tyre arsyetohet me standardin jetësor në Kosovë, përkundër se dispozitat ligjore udhëzojnë se për bazë duhet të merret standardi jetësor paraparak gjatë martesës.

Praktika gjyqësore aktuale nuk është në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Familjen. Për më shumë, është dëshmuar se praktika gjyqësore i shkelë këto dispozita ligjore, e rrjedhimisht edhe ligjin.



## REKOMANDIMET

- Gjykatat kosovare duhet të sigurojnë respektimin i kornizës ligjore në lidhje me ndarjen e pasurisë dhe mbajtjen financiare. Kjo është detyra e tyre.
- Praktika gjyqësore e instaluar në Kosovë në shumë raste përbën shkelje të dispozitave ligjore. Të gjitha shkallët e gjyqësorit që punojnë me këto raste duhet të ofrojnë trajnime për gjyqtarët për ndarjen e pasurisë dhe mbajtjes financiare.
- Gjykatat kosovare duhet të sigurojnë që përmbaruesit e gjykatave të gjejnë mënyra si të realizojnë të drejtën për alimentacion sipas vendimeve gjyqësore.
- Gjykatat duhet të krijojnë praktika të reja, të orientuara në ligj dhe të mos lejojnë që mendësia patriarkale dhe mungesa e profesionalizmit të ndikojë në vendimmarrjen gjyqësore, e cila ka pasoja të rënda për jetën e qytetarëve.
- Gjykatat duhet të inicojnë procedura të reja për mashtrimet ekonomike në martesë, të cilat duhet të jenë në shërbim të së drejtës. Gjykatat duhet të mirren vetë, ex officio, me ndjekjen e veprave penale të mashtrimit financiar/ekonomik në martesë, duke inicuar procedurën penale përmes gjykatës sikurse është e kërkuar për veprat penale.
- Eksperti financiar guxon të angazhohet vetëm për vlerësim material të investimeve në pronë apo të sendeve. Caktimi i vlerës për punën në shtëpi me fëmijë dhe mirëmbajtje të shtëpisë, pra caktimi i vlerës së amvisërise nga një ekspert financiar është praktikë jo vetëm diskriminuese, por edhe e jashtëligjshme, sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore.
- Gjykatat duhet t'i kushtojnë prioritet rasteve të dhunës në familje jo vetëm gjatë procedurave të kërkesave për urdhërbrojtje. Në rastet kur ka pasur dhunë në familje edhe shkurorëzimi dhe ndarja e pasurisë duhet të trajtohen me prioritet, kjo për arsye se gjatë procedurave të stërzgjatura

gratë po pësojnë një degradim social dhe njëherit gjatë asaj kohe po bëhen mashtrimet ekonomike me pasurinë e përbashkët.

# REFERENCAT

## LIBRA

- Aliu, Abdullah (2009). E drejta sendore (pronësia). Universiteti i Prishtinës.
- Aliu, Abdullah dhe Gashi Haxhi (2007). E drejta familjare. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik.
- Aliu, Luljeta (2019). Ndryshimi i Ligjit për Familjen. Iniciatia për Drejtësi dhe Barazi INJECT.
- <https://inject-ks.org/wpcontent/uploads/2019/09/NdryshimiLigjiFamiljen.pdf>
- Bahtiri, Bedri (2013). Punimi i Doktoraturës - Aspektet Nacionale dhe Ndërkombëtare të Regjimit Pasuror Martesor të Bashkëshortëve. Universiteti i Prishtinës, online <https://drive.google.com/file/d/0Bxeq-XV-U8mhSkJCN2NNZFJOVnM/view>
- Gashi, H., Aliu, A. dhe Vokshi, A. (2012). Komentari i Ligjit nr.2004/32 për Familjen i Kosovës. GIZ Kosovë.
- Podvorica, Hamdi (2011). E drejta Familjare. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik.

## RAPORTE DHE ARTIKUJ

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2019, online në <http://ask.rks-gov.net/media/4854/anketa-e-tregut-te->

[punes-tm1-2019.pdf](#)

- Agjencia e Statistikave të Kosovës. “Statistikat e Shkurorëzimeve.” 2018. marrë nga, <http://ask.rks-gov.net/media/4946/statistikat-e-shkurorëzimeve-2018-shqip.pdf>
- Agjencia për Barazi Gjinore, “Siguria fillon në shtëpi”, 2008, online <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/ABGJ%20RAPORTI%20DH%20FAMILJE%20Shqipe.pdf>
- European Centre for Minority Issues. “Doracak Ligjorë: Grupet e cënuara dhe të marginalizuara në Kosovë.” 2012. marrë nga, <http://www.ecmikosovo.org/uploads/18-12-12-ECMI-Kosovo-Legal-Handbook.pdf>
- Farnsworth, Nicole, et al. “Analiza Gjinore e Kosovës”, Rrjeti i Grave të Kosovës. 2018. marrë nga, <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>
- Fejzullahu, Afërdita. “61 vjeçari telefoni policinë: Kam vrarë gruan.” *Kallxo.com*. 2019. marrë nga, <https://kallxo.com/lajm/61-vjecari-telefoni-policine-e-kam-vrare-gruan/>
- Gërxhaliu, Arita. “Viktimës së dhunës nuk i paguhet ushqimi i femijës nga ish bashkëshorti.” *Kallxo.com*. 2017. marrë nga, <https://kallxo.com/viktimes-se-dhunes-nuk-paguhet-ushqimi-femijes-nga-ish-bashkeshorti/>
- Grupi i Ballkanit për Studim Politikash. “Gratë në Politikë.” 2019. marrë nga, <https://balkansgroup.org/blog/post/articles/grate-ne-politike-pabarazia-gjinore-ne-politike-dhe-vendimmarrje>
- Halili, Dafina. “Ndryshimi i Ligjit për të njohur punën e pa paguar.” *Kosovo*

2.0. 2018. marrë nga, <https://kosovotwopointzero.com/law-change-to-see-unpaid-labor-recognized/>

- Morina, Drenusha. “Kur vjen puna te ndarja - Amvisëria nuk njihet si punë.” *Periskopi*. 2018. marrë nga, <https://www.periskopi.com/kur-vjen-puna-te-ndarja-amviseria-nuk-paguhet-e-spo-njihet-si-pune/>
- Organization for Security and Co-operation in Europe. “A Men’s Perspective on Gender Equality in Kosovo.” 2018. marrë nga <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/382507?download=true>
- Rrjetit i Grave të Kosovës, Mjaft më me arsyetime, fq. 46, online [https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/RrGGK\\_Mjaft%20m%C3%AB%20me%20arsyetime\\_2015.pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/RrGGK_Mjaft%20m%C3%AB%20me%20arsyetime_2015.pdf)
- Raporti i Progresit për Kosovën 2018, fq.25, online <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>
- Rrjeti i Grave të Kosovës, „Analiza Gjimore e Kosovës”, fq.25, online në <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>
- Travers, Eve-anne. “Kosovo Protests for International Women’s Day.” *Prishtina Insight*. 2019. marrë nga, <https://prishtinainsight.com/prishtina-protests-for-international-womens-day/>
- <https://inject-ks.org/wpcontent/uploads/2019/09/NdryshimiLigjiFamiljen.pdf>

## LIGJET

- **Ligji i për Familjen i Kosovës. 06/L-077. 2019.**  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>
- **Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Nr.04/L-077,**  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>
- **Komentari i Ligjit për Familjen,** <http://jus.igjk.rks-gov.net/513/>
- **Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, Nr.03/L-154,**  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2643>
- **Ligji NR. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 2004/32 për Familjen i Kosovës,**  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18420>

## INTERVISTAT

Intervistë Personale, Anton Nrecaj, Avokat.

Intervistë Personale, B.B., Grua e Divorcuar.

Intervistë Personale, Blerina Kurtaj, Avokate.

Intervistë Personale, Daut Çelja, Gjyqtar, Gjykata Themelore Drenas.

Intervistë Personale, Daut Krasniqi, Avokat.

Intervistë Personale, Gani Leci, Mbrojtës i Viktimave, Zyra për Mbrojtje të Viktimave.

Intervistë Personale, Halil Zahiri, Gjyqtar, Gjykata Themelore Gjilan.

## PASURIA E PËRBASHKËT DHE MBAJTJA FINANCIARE

Intervistë Personale, Leonora Shemsiu-Kadriu, Koordinatore e Dhunës për Familje.

Intervistë Personale, Nexhat Aliu, Gjykata Themelore në Gjiilan.

Intervistë Personale, Sh.A. Grua e Divorcuar.

Intervistë Personale, Venhar Salihu, Gjyqtar, Gjykata Themelore Gjiilan.

Intervistë Personale. Gazmend Ajvazi, Gjyqtar, Gjykata Themelore Gjiilan.

Interviste Personale. L.A. Grua e Divorcuar.

Intervistë Personale. M.L. Grua e Divorcuar.

Intervistë Personale. Shabani, Mevlide. Gjyqtare. Gjykata Themelore Gjiilan.

# SHTOJCA

## Pyetjet për Gjyqtarë dhe Avokatë

1. Sa mendoni se i gëzojnë gratë të drejtat e tyre në pronën bashkëshortore?
2. Sipas përvojës suaj, çfarë përqindje të pasurisë së përbashkët e kërkojnë gratë gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët?
3. A mund të na tregoni në bazë të cilave kritere/llogari caktohet totali i pasurisë së përbashkët, dmth cilat punë vlerësohen se kanë shtuar vlerën e pasurisë së përbashkët?
4. Sipas statistikave, vëtem 10% e grave posedojnë pronë në emër të tyre. Sa mendoni ju se është mundësia që këto gra këtë pronë ta kenë fituar gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët?
5. Sipas përvojës suaj, në bazë të cilave kritere apo vlerësime përcaktohet pjesa nga pasuria e përbashkët që i ndahet gruas?
6. Sipas përvojës suaj, çfarë përqindje të pasurisë realizojnë gratë në rast se nuk kanë qenë në marrëdhënie pune gjatë kohëzgjatjes së martesës?
7. Sipas përvojës suaj, sa zgjatë për afërsisht procedura e ndarjes së pasurisë së përbashkët?
8. Gjatë intervistave me gratë na është thënë se ka raste kur ndarja e pasurisë ka zgjatur deri në 10 vite. Pse mendoni sa ka ndodhë kjo, apo cilat mendoni se mund të jenë arsyet për këtë zgjatje?
9. Gjatë përcaktimit të kujdestarisë për fëmijë, cilat janë kriteret për ta caktuar se cili prind e merr fëmijun?
10. A ekziston ndonjë udhëzim administrativ apo ndonjë tjetër procedurë e standardizuar dhe e shkruar në lidhje me caktimin e pjesëve të pasurisë së përbashkët?

## PASURIA E PËRBASHKËT DHE MBAJTJA FINANCIARE

11. A mund të na thuani se si bëhet përcaktimi i shumës për alimentacion për fëmijët?
12. A ekziston ndonjë udhëzimi administrativ apo ndonjë tjetër procedurë e standardizuar dhe e shkruar në lidhje me caktimin e alimentacionit?
13. Çfarë kriteresh mirren për bazë për caktimin e vëllimit të alimentacionit?
14. Çfarë kriteresh mirren për bazë për caktimin e vëllimit të ushqimisë?
15. Për cilat nevoja të bashkëshortit jepet ushqimia, dmth cilat shpenzime të bashkëshortit të papunë mbulohen nga bashkëshorti I punësuar?
16. Në raste të një vendimi të gjykatës për alimentacion dhe ushqimi, cili organ e siguron që ai vendim gjyqësor të respektohet dhe të zbatohet detyrimi ligjor?

## Pyetjet për Gratë e Divorcuara

1. Sa vjeçe jeni?
2. A keni fëmijë? Sa fëmijë i keni?
3. çfarë moshe kanë fëmijët?
4. Para sa kohe jeni divorcuar?
5. Sa kohë ka zgjatur martesë jua?
6. Sa ka zgjatur procedura e shkëputjes?
7. A e keni kërkuar ndarjen e pasurisë?
8. Sa kohë ka zgjatur procedura për ndarjen e pasurisë?
9. A e keni kërkuar gjysmën e pasurisë?
10. A keni pasur avokat?
11. A keni pasur përshtypjen se keni qenë e mbrojtur mirë nga avokati?
12. A e keni fituar gjysmën e pasurisë së përbashkët të krijuar gjatë martesës?



13. A keni pasur shtëpi/banesë në emër tuajin dhe të burrit?
14. Nëse keni pasur shtëpi/banesë të përbashkët në emër të burrit (apo në emër të përbashkët), a është ndarë nga gjykata ajo banesë në gjysëm sipas vlerës monetare që e ka për tu caktuar sa ju takon juve? Nëse jo, si është ndarë?
15. A keni punuar?
16. Si, në çfarë mënyre apo me cilat metoda është konstatuar vlera që ju kanë caktuar se ju takon juve?
17. A ka pasur burri juaj pasuri të veçantë, dmth pasuri para kurorëzimit/martësës me juve?
18. A ka pasë nevojë për ekspert financiar, i cili e ka bërë llogarinë se sa ju takon juve prej pasurisë?
19. Gjatë caktimit të pjesëve të pasurisë së përbashkët, a kanë kërkuar nga ju të ofroni dëshmi për kontributin tuaj gjatë martësës? Nëse po, çfarë ju kanë kërkuar, ose çka keni dorëzuar ju si dëshmi të kontributit tuaj?
20. A keni kontribuar edhe materialisht në pasurinë e përbashkët? Si? Nëse keni punuar, sa ka qenë rroga juaj?
21. Nëse nuk keni qenë në marrëdhënie pune gjatë kohëzgjatjes së martësës, çfarë vlere mujore ju është caktuar juve si nënë për kujdesjen ndaj fëmijëve dhe shtëpisë?
22. A mendoni se ndarja e pasurisë së përbashkët ka qenë korrekte? A jeni e kënaqur me pjesën që ju është ndarë juve?
23. Cilët prej prindërve i është caktuar kujdestaria për fëmijët, dmth me kë jetojnë fëmijët, me juve apo me babain?
24. A keni kërkuar që fëmijët të jetojnë me juve?
25. Nëse gjykata nuk jau ka dhënë juve fëmijët, me çfarë arsye nuk jau ka dhënë në për kujdesje?

- 26.** A është caktuar alimentacioni për fëmijët?
- 27.** Burri juaj, si ka qëndruar ekonomikisht? Shumë mirë, mirë, mesatare, keq, shumë keq
- 28.** Çfarë të ardhurash mujore ka pasur burri juaj?
- 0-200
  - 200 – 400
  - 400 – 600
  - 600 – 800
  - 800 – 1000
  - 1000 – 1200
  - 1200 – 1400
  - 1400 – 1600
  - 1600 – 1800
  - 1800 – 2000
  - Mbi 2000
- 29.** Burri juaj a ka pasur biznes? Nëse po, sa punëtorë l ka pasur biznesi?
- a.** 1 – 3
  - b.** 3 - 5
  - c.** 5 – 10
  - d.** 10 – 15
  - e.** 15 – 20
  - f.** 20 – 30
  - g.** 30 – 50

- h.** 50 – 100
- i.** 100 – 200
- j.** 200 – 300
- k.** Mbi 300

- 30.** Sa mendoni se është vlera e pasurisë së burrit tuaj?
- 31.** Gjatë procedurave gjyqësore, a keni pasur ndjenjë se po trajtoheni me korrektësi nga ana e gjykatës/gjyqtarëve? Shumë korrekt, korrekt, nuk e di, me shkelje të korrektësisë, shumë jo-korrekt
- 32.** Gjatë procedurave gjyqësore a keni dyshuar apo keni edhe fakte për manipulim të procesit, apo korrupsion, ndikim në vendimmarrje, apo anshmëri në vendimmarrje?
- 33.** Sa mendoni se i njihni të drejtat e juaja ligjore si grua dhe nënë? Shumë mirë, mirë, nuk e di, jo mirë, aspak
- 34.** Çfarë shkollimi keni mbaruar? Pa shkollim, Filllore, e mesme, universitet, master, doktorate
- 35.** Çka jeni me profesion apo çfarë keni studiuar/çfarë drejtimi në shkollë?
- 36.** Gjatë procedurave gjyqësore, sa mendoni se janë respektuar të drejtat e juaja në vendimmarrje?
- a.** Fare hiç
  - b.** Pak
  - c.** Nuk e di
  - d.** Deri diku
  - e.** Plotësisht
- 37.** Sa vjeç kanë qenë fëmijët kur jeni ndarë?

- 38.** Nëse fëmijët jau kanë besuar juve në përkujdesje, a keni marrë alimentacion për fëmijët?
- 39.** Nëse gjykata ka vendosur se ju takon alimentacion, sa ka qenë shuma që është caktuar për një fëmijë?
- 40.** A e keni marrë me rregull alimentacionin?
- 41.** Nëse jo, pse nuk e keni marrë me rregull?
- 42.** Nëse burri juaj është dashur të paguajë alimentacion, por nuk e ka bërë, a jeni ankuar tek organet përgjegjëse? Nëse po, ku jeni ankuar?
- 43.** Nëse burri juaj nuk e ka paguar alimentacionin dhe ju jeni ankuar për këtë, a ka pasur pasoja pas ankesës, dmth a është interesuar ndonjë institucion që të zbatohet vendimi i gjykatës për alimentacion nga burri juaj?
- 44.** Nëse fëmijët i keni marrë ju dhe kanë pasur moshë të vogël nën 15 vjet, juve përpos alimentacionit ju takon edhe mbajtje financiare (ushqimi) për juve. A ju kanë dhënë ushqimi për juve?
- 45.** Sa ka qenë shuma e ushqimisë për juve?
- 46.** Nëse keni pasur shtëpi në emër të burrit (apo të të dyve), kujt i është lënë shtëpia pas ndarjes?
- 47.** Si ka ndryshuar statusi juaj social, dmth gjendja ekonomike e juaj pas ndarjes? Shumë më keq, më keq, njejtë, më mirë, shumë më mirë
- 48.** Nëse nuk ju bezdisë, a mund të na tregoni arsyen e ndarjes?
- 49.** A keni përjetuar dhunë ekonomike? Si?
- 50.** A keni përjetuar dhunë psikike? Si?
- 51.** A keni përjetuar dhunë fizike?
- 52.** A e keni lajmëruar ish burrin për dhunë në policia apo gjykatë?



Ky hulumtim u mundësua nga Programi i Angazhimit për Barazi (E4E), i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC. Përmbajtja është përgjegjësi e INJECT dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC, USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.





**[www.inject-ks.org](http://www.inject-ks.org)**

**FB:** INJECT Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi

**INSTA:** injectorg